

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Për Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Shkenca
Politike”,**

ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Eksperte e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof.Assoc.Dr. Merita Xhumari



Korrik/2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 291, datë 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Shkenca Politike"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	17 studentë (viti akademik: 2012-2013) 14 studentë (viti akademik: 2013-2014) 36 studentë (viti akademik: 2014-2015) 17 studentë (viti akademik: 2015-2016) 17 studentë (viti akademik: 2016-2017) 13 studentë (viti akademik: 2017-2018) Total: 114 studentë (periudha 2012-2018)

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Politike"

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është vlerësuar në kuadër të licencimit/hapjes në Shkollën e Lartë "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", proces i finalizuar me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 256, datë 16.09.2011, dhe është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 482, datë 03.10.2011, në përputhje me Vendimin e KA. Ky Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 256 datë 16.09.2011, në pikën 6 shprehet se "Përmbajtja e Programit të ri të studimit, Msc. në "Shkenca Politike", përmbush standardet e cilësisë dhe për këtë arsye jep vlerësimin Pozitiv për hapjen, me sugjerimet: a) Të paraqitet lista e personelit akademik të ndarë në efektiv dhe me kontratë me kualifikimin përkatës; b) Të paraqiten bashkëpunime për realizimin e praktikave mësimore; c) Të paraqiten të dhëna për mjediset dhe facilitetet; d) Të paraqiten fushat e pranimi në këtë program studimi. Për rekomandimin e parë, institucioni ka paraqitur listën e personelit akademik të ndarë në efektivë dhe me kontratë që përmbushin kualifikimin përkatës me gradën shkencore "Doktor" të përshtatshëm për të realizuar programin në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor në "Shkenca Politike". Për bashkëpunimet për realizimin e praktikave mësimore, institucioni ka paraqitur marrëveshje të konfirmuara nga stafi akademik që ndjek praktikat dhe nga studentët që janë përfshirë në praktikë. Për mjediset dhe facilitetet, gjatë vizitës në institucion u verifikua që ai ka mjedise të përshtatshme për auditore, salla laboratoresh me kompjutera, biblioteka dhe salla konferencash, me akses në internet, në bar dhe restorant. Për fushat e pranimi në këtë program studimi, ai është i hapur për të gjitha fushat e shkencave sociale, administrimit, biznesit, juridike dhe ato të shkencave humane dhe arteve, referuar të dhënave të studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Nuk ka të përcaktuara kufizime dhe kritere hyrëse sa i takon fushave të studimit dhe janë respektuar kërkesat ligjore dhe standardet shtetërore për pranimet në programet Master Shkencor.

Në bazë të Urdhërit Nr. 124, datë 29.03.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht dhe më pas janë akredituar programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master Shkencor dhe Master Profesional. Akreditimi i parë i programit të studimit Master Shkencor në "Shkenca Politike" është realizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 291, datë 11.07.2012, sipas Pikës 3, referuar VKA Nr. 334, datë 08.06.2012 me rekomandime si më poshte:

- a) Institucioni duhet të forcojë programet studimore në përputhje me kërkesat e tregut.
- b) Institucioni duhet të angazhojë personel akademik të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të tij.
- c) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Programi i studimit Master Shkencor në "Shkenca Politike" organizohet nga Departamenti i Shkencave Politike i Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, konfirmuar me Vendim Senati Nr. 6/1, datë 19.05.2017 të këtij universiteti. Sipas dokumentit të "Strategjisë së programit të studimit", misioni kryesor është edukimi i profesionistëve dhe zhvillimi i aftësive teoriko- aplikative me qëllim që aspirantët e rinj të shkencave politike të jenë të aftë që t'i përdorin këto njohuri në shërbim të publikut. Në ditën e dytë të vizitës në institucion që u zhvillua në datat 31 Maj – 1 Qershor, GVJ i'u paraqitën dokumenta për ndryshimet në këtë program. Na u paraqit shkresa e MASR nr. 2752/1 Prot., datë 24.04.2018, me anë të së cilës pranohen ndryshimet e deklaruara nga UMSH në masën 20% për programin e studimit Master Shkencor në "Shkenca Politike" duke e titulluar Master Shkencor në "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit". Këto ndryshime do të hyjnë në funksion në vitin e ardhshëm akademik dhe GVB nuk mund të shprehet dhe të vlerësojë këto ndryshime përderisa ato nuk janë aktivizuar ende.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.Assoc.Dr. Merita Xhumari

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit GVJ u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, znj. Emisa Isufaj. Më datë 24.07.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 87/43 Prot., datë 25.07.2018 me lëndë "Njoftim për dërgimin e draft – Raporteve të vlerësimit të jashtëm", Universiteti

“Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 01.08.2018, UMSH përcjell nëpërmjet sistemit AMS në ASCAL “Objeksione për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike”, ndërsa me shkresë Nr. _____ Prot., datë _____ ato sillen zyrtarisht në protokollin e ASCAL. GVJ pasi lexoi me kujdes komentet e IAL, vendosi të rikonfirmojë analizën dhe konkluzionet e nxjerra në draft-Raport. Si përfundim, Raporti i Vlerësimit të Jashtëm **nuk u ndryshua**.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Institucioni duhet të forcojë programet studimore në përputhje me kërkesat e tregut.
2. Institucioni duhet të angazhojë personel akademik të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të tij.
3. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. Ndonëse UMSH ka vendosur në objektivat e tij dhe strategjinë e programit të studimit përmirësimin e tij, deri në 2018 programi mbetet i ngurtësuar e pa ndryshime, megjithë ndryshimet në personelin akademik dhe strukturat institucionale.
2. Institucioni ka angazhuar personel akademik të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të tij referuar verifikimit të dosjeve të personelit akademik të rekrutuar me kohë të plotë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Institucioni ka konsideruar rritjen sasiore dhe cilësore të personelit akademik me grada e tituj shkencorë, duke arritur në krijimin e një Departamenti të Shkencave Politike që përmbush kërkesat ligjore me personel akademik efektiv, nga të cilët së paku tre janë me gradën shkencore “Doktor”. Në realizimin e programit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me përjashtim të dy asistent lektorëve, nga të cilët njëri personel akademik me kontratë, gjithë të tjerët janë personel akademik efektiv me gradën “Doktor i Shkencave”.
3. Institucioni bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 14, datë 28.03.2011 iu ka kërkuar studentëve të këtij programi studimi të japin që në fillim, jo në përfundim të studimeve, provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, sikurse na u bë e ditur nga takimi në Sekretarinë mësimore të UMSH. Ndonëse nga konsultimi i dosjeve të studentëve u konstatua mungesa e dokumentit të mbrojtjes së gjuhës së huaj.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka avancuar në këtë pesëvjeçar me zhvillime institucionale të dukshme duke kaluar nga Shkolla e Lartë në Universitet me qëllime dhe objektiva të qarta për rritjen e nivelit të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Në faqen e tij në internet www.umsh.edu.al është përcaktuar qartë se qëllimi i tij është “përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit”. Në këtë kontekst

None

Programi Master Shkencor në “Shkenca Politike” i akredituar për herë të parë në vitin 2012, aktualisht në proces riakreditimi, është një program i cili i përgjigjet kërkesave në rritje për këtë degë studimesh nga ana e studentëve të shkencave sociale, por jo vetëm, sepse programi ka hapur mundësitë edhe për të diplomuar në degë të tjera, si të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” apo të universiteve të tjera publike e private në vend. Në përputhje me strategjinë e UMSH është hartuar edhe strategjia e këtij programi studimi bazuar në qëllimet, misionin dhe objektivat e institucionit të shprehura në strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të tij. Këto objektiva realizohen nga një staf akademik dhe drejtues me vizione të qarta dhe kontribute në qeverisjen e vendit, të cilët kanë arritur në ndryshime thelbësore në UMSH vitin e fundit akademik 2017-2018.

Me Urdhrin Nr. 273 datë 18.05.2017 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi bazën e kërkesës së SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, është miratuar hapja e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike” dhe riorganizimi i njësisë kryesore nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare”. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike organizohet në tre njësi bazë me strukturën si më poshtë:

1. **Departamenti i Shkencave Politike** që organizon këtë program Masteri Shkencor në Shkenca Politike
2. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;
3. Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë;

Para kësaj periudhe, organizimi i njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, kishte në përbërje të tij departamentet:

1. **Departamenti i Shkencave Politike**
2. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3. Departamenti i Shkencave Juridike

Programi i studimit Masteri Shkencor në “Shkenca Politike” është hartuar në mënyrë të tillë që t’i përgjigjet nevojave të studentëve të Bachelorit të “Shkencave Politike” dhe degëve të tjera për të vazhduar studimet Master dhe të nevojave të tregut të punës për studiues të shkencave sociale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	3. Programi i studimit Master Shkencor në “Shkenca Politike” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” për të përgatitur specialistë të aftë në fushat e shkencave politike i shpalluar në faqen e tij në internet www.umsh.edu.al “përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit”.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	4. Programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që t’i përgjigjet nevojave të studentëve të Bachelorit të “Shkencave Politike” për të vazhduar studimet Master dhe të nevojave të tregut të punës. Programi i studimit është hartuar bazuar në përvojën e stafit dhe

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>bashkëpunëtorëve të tyre vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe kërkesave në rritje të studentëve, duke iu përgjigjur nevojave, ndonëse një studim i mirëfilltë tregu mungon.</p> <p>5. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar duke mbajtur parasysh strategjitë e zhvillimit ekonomik e social të vendit.</p> <p>6. Programi pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit tonë referuar literaturave të studjuesve shqiptarë në syllabuset e lëndëve dhe metodave për realizimin e tyre. Duket se për hartimin e këtij programi, UMSH është bazuar në Strategjinë Kombëtare, Legjislacionin për arsimin e lartë, Strategjinë e Zhvillimit të UMSH, si rrjedhojë, programi nuk përmban elemente të cilët të bien ndesh me vlerat kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>1. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit me të cilën u konsultuam gjatë vizitës në UMSH dhe diskutimeve me stafin menaxherial të programit. Gjithashtu janë mbajtur në konsideratë objektivat e programit, kërkesat kurrikulare, nevoja për zhvillimin dinamik të syllabuseve referuar literaturave të reja dhe punës shkencore të profesorëve.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>1. Përmbajtja e programit të studimit Master Shkencor në “Shkenca Politike” është konceptuar dhe ndërtuar mbi bazën e zhvillimit logjik të formimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në shkencat sociale. Ajo i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore teorike dhe aftësi për kërkim shkencor në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>2. Programi i studimit i ciklit të dytë Master Shkencor në “Shkenca Politike” është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve. Kriteri gjen zbatim referuar programit i cili parashikon semestrin e parë njohuri të thelluara teorike dhe mbi metodat e kërkimit shkencor dhe në semestrat e tjerë njohuritë thellohen duke zhvilluar edhe kompetencat e aftësitë përmes praktikës profesionale.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Shkencave Politike i cili është përgjegjës për programin e studimit Master Shkencor në "Shkenca Politike" bën pjesë në strukturën e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, një nga tre fakultetet kryesore të UMSH. Ky fakultet ofron 2 programe studimi në nivelin e parë Bachelor; 2 programe studimi në nivelin Master Shkencor; dhe 1 program studimi Master Profesional. Konkretisht:

- Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profile: a. Shkenca Politike; b. Administratë Publike
- Bachelor në Studime Psikosociale
- MP në Shkenca Politike dhe Administrative me profile: a. Politika Sociale; b. Administratë Publike; c. Qeverisje Vendore
- MSh në Shkenca Politike
- MSh në Psikologji me profile: a. Psikologji Organizative; b. Psikologji Komunitare

Programi Master i Shkencave Politike "Shkenca Politike" mbulohet nga Personeli Akademik Efektiv i Departamentit të Shkencave Politike. Departamenti përmbush kriteret ligjore ku minimumi kërkohet 7 PAE, nga të cilët mjaftojnë 3 pedagogë me gradën shkencore Doktor. Vetëm 2 PAE nga Departamenti i Shkencave Politike janë në proces doktorature. Personeli Akademik me Kontratë (PAK) i Departamentit të Shkencave Politike është i pakët duke ndryshuar në favor të PAE raportin e forcave si një nga rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. Staf i brendshëm i Departamentit të Shkencave Politike në realizimin e programit Master Shkencor në "Shkenca Politike" mbështetet edhe nga stafi akademik i departamenteve të tjera të këtij Fakulteti dhe nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Personeli administrativ është i mjaftueshëm, gati i njëjtë në numër me personelin akademik dhe realisht mbështetës për realizimin e procesit mësimor. Baza e të dhënave të njësisë për stafin gjendet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku u shqyrtuan dosjet e personelit me të gjitha të dhënat. Përgjegjësia e mbajtjes dhe e dhënies së informacionit i përket drejtuesve të strukturave sa më sipër, ndonëse informacioni bazë është lehtësisht i aksesueshëm edhe në web-in e UMSH.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është i strukturuar me tre Fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Ekonomike,
- Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, dhe
- Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Departamenti i Shkencave Politike përgjegjës për programin e studimit *Master i Shkencave në "Shkenca Politike"* është pjesë përbërëse e **Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike**, i cili ka edhe dy departamente të tjera që funksionojnë si njësi bazë: Departamentin e Psikologjisë dhe Sociologjisë dhe Departamentin e Administrimit Publik dhe Formimit Bazë. Konfirmohet skema në RVB f.13 me organigramën e strukturës së UMSH e cila është në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në IAL në RSH.

Stafi i brendshëm i fakultetit është i organizuar në disa bërthama (grup-lënde) ku ndodhen pedagogë të fushave të studimit të përafërta si: Shkenca Politike; Shkenca Administrative dhe Teoritë e Integritit.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Nga vizita dhe takimet me stafin akademik në UMSH, konfirmohen të dhënat mbi personelin që janë pasqyruar në aneks, Tabela nr.1 dhe Tabela nr.2, të dhënat e detajuara në lidhje me stafin akademik të Departamentit të Shkencave Politike i cili është përgjegjës për organizimin e këtij programi Masteri. Ky Departament, për vitin akademik 2017-2018, ka në përbërje: 8 pedagogë të brendshëm, përfshirë edhe Rektoren, i cili realisht është në pension, nga të cilët 4 kanë

gradën shkencore Doktor dhe 2 pedagogë janë në proces doktorature. Ka dhe 3 pedagogë si personel akademik me kontratë.

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti i Shkencave Politike 11 PAE /7 PAK

Për vitin akademik 2015-2016 Departamenti i Shkencave Politike 8 PAE /2 PAK

Për vitin akademik 2014-2015 Departamenti i Shkencave Politike 6 PAE /5 PAK

Për vitin akademik 2013-2014 Departamenti i Shkencave Politike 7 PAE /6 PAK

Për vitin akademik 2012-2013 Departamenti i Shkencave Politike 8 PAE /6 PAK

Në një hark kohor prej gjashtë vitesh që prej akreditimit të parë, institucioni duket se i ka zbatuar rekomandimet e këtij akreditimi, duke e rregulluar ndjeshëm raportin PAK/PAE, nëpërmjet kualifikimit të pedagogëve ekzistues që kanë marrë gradën shkencor Doktor dhe rekrutimit të stafit akademik me doktoratura jashtë vendit. Në kushtet e krijimit të Departamentit të Shkencave Politike dhe të programeve Bachelor, Master Shkencor e Master Profesional në "Shkenca Politike", mund të jetë e nevojshme të vazhdojë të rritet numri i stafit akademik të brendshëm me gradën Doktor të Shkencave Politike, apo me tituj Profesorë. Gjendja e konstatuar në institucion reflekton një frymë të mirë bashkëpunimi mes drejtuesve të IAL-së dhe pedagogëve, në funksion të kualifikimit të këtyre të fundit. Informacioni i dhënë në RVB rezultoi me disa mospërputhje të lehta si numri i PAE, jo thelbësore për procesin e akreditimit. PAE dominohej kryesisht nga grupmosha 30-45 vjeç dhe angazhohej jo vetëm në mësimdhënie dhe punë kërkimore shkencore, por edhe në punë administrative të UMSH që mbështesin aktivitetin mësimor e shkencor.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga takimet me titullarët e institucionit morëm Vendimin nr.6/1, datë 19.05.2017 të Senatit Akademik të UMSH mbi organizimin e programeve të studimit nga njësitë përgjegjëse në përputhje me strukturën e miratuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	<p>1. UMSH ka realizuar një riorganizim në mënyrë që të përmbushë misionin e tij si universitet tashmë, duke zbatuar edhe detyrat e lëna nga akreditimi i mëparshëm sipas kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL Republikën e Shqipërisë nr. 80/2015.</p> <p>2. UMSH është organizuar dhe funksionon në përmbushje të plotë të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore duke u zgjeruar nga dy në tre Fakultete.</p> <p>3. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka në përbërje tre departamente si njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë 2. Departamenti i Shkencave Politike 3. Departamenti i Administratës Publike dhe i Formimit Bazë <p>4. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ka objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin e performancës bazuar në parametra të matshëm; • Komunikimin në auditor dhe interaktivitetin real; • Përfshirjen e studentëve në punë të pavarur shkencore; • Përhapjen e përvojave më të përparuara; • Nxitjen e diskutimeve teorike-aplikative duke u adresuar në problematikat e
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si	

<p>personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>mprehta që rekomandon shoqëria jonë në dinamikën e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrjen në aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni (RVB, f.11) të verifikuara gjatë takimeve me stafin dhe studentët <p>5. Departamenti ka në përbërje së paku 7 anëtarë efektiv si personel akademik duke përmbushur kriteret ligjore, ku së paku 3 anëtarë të personelit janë me gradën shkencore "Doktor", referuar verifikimit të të dhënave në dosjet e personelit nga ZBNJ dhe takimeve të drejtpërdrejta me stafin akademik gjatë vizitës në UMSH.</p>
---	--

Standardi II.3 - Njësiti e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësiti bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësiti bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>1. Në drejtimin e Fakultetit dhe të Departamentit janë zgjedhur personalitete me përvojë akademike dhe të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë në realizimin e programit Master i Shkencave në "Shkenca Politike". Kjo u konstatua gjatë takimit me ta në fillim të vizitës në UMSH. Referuar Rregullores së programit dhe RVB f.15 "Përgjegjësitë e njësisë bazë në realizimin më efektivitet të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" shprehen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Seriozitetin në punë duke qenë shëmbull në disiplinën formale dhe atë shkencore-akademike. • Rigorozitetin në drejtimin dhe kërkesën e llogarisë. • Nxitjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e punës dhe programeve të studimit. • Dhënien e shëmbullit personal në fushën e kërkimit shkencor". <p>2. Mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" Departamenti dhe Fakulteti përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik dhe në vlerësimin e tij sikurse u konfirmua nga takimet me stafin akademik dhe ZBNJ të UMSH.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Universteti "Mesdhetar i Shqipërisë" për përmbushjen e misionit të tij organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, Ligjin 80/2015. Ka një ndryshim nga akreditimi i vitit 2012 në organizimin e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" i cili përbëhet nga tre Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, dhe ish Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike është ndarë në dy Fakultete, duke krijuar Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Çdo fakultet përbëhet nga tre njësi bazë – departamente. Departamenti i Shkencave Politike ka në përbërjen e tij, në përputhje me Standardet shtetërore të cilësisë 7 anëtarë efektivë si personel akademik dhe më shumë se 3 anëtarë të personelit akademik efektivë me gradën shkencore "Doktor".

Standardi II.2 përmbushet pasi Fakulteti dhe Departamenti angazhohen drejtpërsëdrejti dhe me përkushtim në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" mbështetur në përvojën akademike dhe eksperiencën në fushat përkatëse të PAE, PAK dhe atij administrativ.

Standardi II.3 përmbushet mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" Departamenti dhe Fakulteti përfshihen në rekrutimin e personelit. Rekrutimi i personelit akademik realizohet nga ZBNJ në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli i Departamentit të Shkencave Politike për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" ndahet në: personel akademik, personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personel administrativ. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët dhe detyra administrative. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv (PAE) dhe personel akademik me kontratë (PAK). Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar sipas tematikave të zgjedhura. Në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 12 pedagogë të personelit akademik efektivë me gradën shkencore Doktor, duke përmbushur tërësisht dispozitat ligjore në fuqi, si dhe detyrimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm. Ngarkesa e tyre shkon mesatarisht në 3-4 lëndë, me një ngarkesë deri në 270 orë mësimore, relativisht e lartë, në situatën që stafi akademik angazhohej edhe me detyra administrative si në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, apo Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Tutorazhin për studentët, etj. Pedagogët në proces doktorature kanë ngarkesa më të ulëta. Personeli akademik është në numër të barabartë me personelin administrativ që mbështet dhe lehtëson procesin mësimor dhe kërkimor. Sa i takon angazhimin të personelit akademik në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" për periudhën 2012-2018, të dhënat e grumbulluara nga UMSH dhe dokumentet në sistemin e ASCAL janë të pasqyruara në Tabelën nr. 4 në aneks. Departamenti për të plotësuar nevojat e tij në realizimin e programit të studimit në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore përcakton para fillimit të çdo viti akademik kërkesat për personel akademik. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik pasi miratohet nga Dekani dhe Rektori, publikohet on-line në faqen zyrtare të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", në median elektronike dhe të shkruar (www.umsh.edu.al). Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës nga një komision i veçantë, ku marrin pjesë Rektori/Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës "Mesdheu". Institucioni disponon një bazë të dhënash të personelit efektiv dhe me kontratë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Referoju Tabeles se Planit ne aneks).

Në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" për vitin akademik **2017-2018** janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik të UMSH, me gradën shkencore "Doktor". Vetëm dy asistentë të titullarëve Dr. janë me Msc, nga të cilët një PAK. Referuar Tabeles nr.4 në aneks, pas verifikimit gjatë vizitës në institucion, konfirmohet stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" ka përmbushur rekomandimet e akreditimit të 2012. Të dhënat e detajuara për të gjitha vitet akademike nga akreditimi i parë për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Shkenca Politike jepen në Aneks, Tabela nr. 4.

- Për vitin akademik 2016-2017 Stafi akademik i programit të studimit 8 PAE /2 Prof. Assoc.Dr, 4 Dr, 2 Msc dhe 4 PAK/ 3 Prof.Assoc.Dr, 1 Msc.
- Për vitin akademik 2015-2016 Stafi akademik i programit të studimit 10 PAE /3 Prof. Assoc.Dr, 4 Dr, 3 Msc dhe 2 PAK/ 1 Prof.Assoc.Dr, 1 Msc.

- Për vitin akademik 2014-2015 Staf i akademik i programit të studimit 10 PAE /2 Prof.Assoc.Dr, 5 Dr, 3 Msc dhe 2 PAK/ 1 Prof.Assoc.Dr, 1 Msc.
- Për vitin akademik 2013-2014 Staf i akademik i programit të studimit 8 PAE /1 Prof.Assoc.Dr, 4 Dr, 3 Msc dhe 3 PAK/ 2 Dr, 1 Msc.
- Për vitin akademik 2012-2013 Staf i akademik i programit të studimit: 8 PAE/ 1 Prof.Dr, 4 Dr, 3 Msc dhe 4 PAK/ 2 Dr, 2 Msc.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator i/ët e programit të studimit (Referoju Tabeles se Planit ne aneks)

Këshilli Shkencor i Programit të studimit përbëhet nga tre pedagogë me titullin Prof.Assoc. Drejtuesja e kësaj njësie është edhe drejtuese e Këshillit Drejtues të Programeve Bachelor dhe Master i Shkencave në "Shkenca Politike", edhe drejtuese e NJSBCZHK që lehtësisht siguron monitorimin e standardeve të cilësisë në hartimin e kurrikulave dhe syllabuseve si edhe në zbatimin korrekt të tyre.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Referoju Tabelës në aneks)

Nga viti 2012 i akreditimit të parë, Departamenti i Shkencave Politike ka përmirësuar cilësinë e stafit akademik efektiv, ku vetëm 1 pedagog nuk ka gradën shkencore "Doktor" në 2017-2018.

- Të dhënat sipas gjinisë (Referoju Tabelës në aneks)

Nga të dhënat sipas gjinisë rezulton që 4 pedagogë nga PAE janë gra dhe 8 janë burra, kurse nga PAK ka vetëm një grua, pra ruhet një ekuilibër edhe gjinor me rreth 40% të gra të stafit akademik.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Referoju Tabelës në aneks)

Dominimi i personelit akademik efektiv të grupmoshes 36-45 është premtues për zhvillimin e këtij programi studimi, aq më tepër që janë të kompletuar me gradën shkencore Doktor. Titullarët afër moshës së pensionit kanë përgatitur dhe mbështetur pasardhësit, duke garantuar vijimësinë e suksesit të programit të studimit.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë nr.80/2015, Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" dhe akteve të tjera ligjore në fuqi përcaktohen të drejtat dhe detyrat e PAE dhe PAK si dhe kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhënien juridike të punës. Fillimi i punësimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik konsiderohet data e nënshkrimit të kontratës së punës nga Rektori. Zyra e Burimeve Njerëzore mban të dhëna të rregullta mbi kontratat e personelit akademik të kategorive "Profesorë" dhe "Lektorë" që punësohen me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar, ndërsa personeli akademik i kategorisë "Asistent Lektorë" punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar një vjeçare. Kontrata e punës përmban identitetin e palëve, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, kohëzgjatjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara, afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, elementet përbërëse të pagës, kohën normale javore të punës (Nga verifikimi i kontratës së M.A. thuhet nga e hëna në të dielë?). Ndonëse UMSH qendron i hapur përgjatë gjithë vitit, kujdesej që stafi akademik efektiv dhe ai mbështetës e administrativ të realizojë pushimet vjetore sipas legjislacionit në fuqi.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli ndihmës administrativ është në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte optimale me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Konkretisht, IT-ja siguron mbulimin audio-viziv në çdo auditor ku zhvillohen leksione, seminare, punë shkencore apo aktivitete të tjera të ngjashme, si dhe shërbimin e pandërprerë të internetit (wifi). Biblioteka është në funksion të realizimit të këtij programi studimi me librarinë online Questia dhe literaturat e kërkuara për çdo lëndë. Aty studentët mund të sigurojnë leksionet e shtypura të pedagogëve. Sekretaria është në shërbim me kohë të plotë në mënyrë operative, funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Sekretaria mësimore kishte të sistemuara në sistem elektronik bazën e të dhënave për studentët që nga fillimi i programit, të cilat ekzistojnë në dokumentuara edhe nëpër rregjistra sipas formatit të regjistratve të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Për realizimin me sukses të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është angazhuar në mënyrën më optimale personeli akademik si dhe personeli ndihmës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>1. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMSH angazhohet në arritjen e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" në ndërtimin dhe realizimin e plotë të programit bazuar në njohjen e kornizës kurikulare dhe përfshirjen e specialistëve të fushës së shkencave sociale.</p> <p>2. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMSH angazhohet në përputhje me strategjinë e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë". Për të mundësuar përditësimin e syllabuseve vjen në ndihmë pasurimi i vazhdueshëm i bibliotekës me libra fizik dhe elektronik dhe me mbajtjen korrekte të të dhënave administrative. IT-ja siguron mbulimin audio-viziv në çdo auditor ku zhvillohen leksione, seminare, punë shkencore.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>1. Personeli akademik është përgjegjës kryesor për hartimin e kurrikulës. Procesi i hartimit dhe miratimit të kurrikulave është bazuar tek parimet dhe kriteret e Ligjit për arsimin e lartë 80/2015 dhe standardet shtetërorë të cilësisë. Kurrikula për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është hartuar dhe realizohet nga Departamenti i Shkencave Politike si njësi bazë ku përfshihet gjithë personeli akademik, sikurse rezultoi nga takimet me ta në UMSH.</p> <p>2. Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe bazuar në kriteret e parashikuara në Statutin dhe Rregulloren e UMSH. Procedura e rekrutimit të stafit akademik është e hapur sikurse treguan rastet e personelit akademik efektiv gjatë bisedave</p>

	me ta në UMSH. Personeli akademik është përzgjedhur me gradën shkencore “Doktor”, duke respektuar kërkesat e Ligjit 80/2015. Personeli akademik efektiv krahas ngarkesave mësimore që shkojnë në 270 orë në auditor, realizon 3-4 lëndë mësimore dhe angazhohet edhe me punë administrative.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>1. Institucioni ndjek një procedurë ligjore transparente përmes shpalljes publike fillimisht në web-in e IAL-së) të vendeve të lira për rekrutimin e personelit. Kriteret hartohen në bazë të dispozitave ligjore si edhe kërkesave specifike të departamentit. Thirrjet për rekrutimin e personelit akademik publikohen në Qershor e Shtator të çdo viti kalendarik (pra në fund e në fillim të vitit akademik). Pas një faze të parë të shqyrtimit të dosjeve, kandidatët i nënshtrohen një intervistimi para një komisioni ad hoc të ngritur nga ZBNj.</p> <p>2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën nga 70% - 90% të personelit akademik të programit Master Shkencor në “Shkenca Politike” përgjatë periudhës 2012-2018, që tregon për përmbushjen e një prej rekomandimeve të lena nga akreditimi i parë (Shih Tabelën nr.4 në aneks).</p> <p>3. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për vlerësimin e personelit në disa nivele: nga titullarët, nga studentët dhe vetëvlerësimet sikurse u verifikua gjatë diskutimeve me drejtuesit, stafin akademik dhe studentët në UMSH dhe formateve të vlerësimit që u vunë në dispozicion. Konfirmohet ajo çfarë përshkruhet në RVB se: “Aspektet kryesore të vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Proçesi i mësimdhënien dhe veprimtaria shkencore e pedagogëve • Veprimtari të tjera në shërbim të programit, njësisë dhe institucionit • Puna me studentët në veprimtari ekstrakurrikulare • Kontributi me futjen e ideve të reja, teorike dhe metodologjike • Pasurimi i literaturës në bibliotekë në fushat konkrete • Respektimi i afateve për kualifikimin shkencor në marrjen e titujve dhe gradave • Proçesi i mësimnxënie. <p>4. Zyra e Burimeve Njerëzore përgjegjëse për bazën e të dhënave disponon një bazë të kënaqshme të dhënash për proceset e rekrutimeve të mëparshme me listën e plotë të PAE/PAK, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe të personelit administrativ.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtuesi i Këshillit Shkencor të programit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” N.Xh. ka gradën shkencore “Doktor” dhe titullin “Profesor i Asociuar”. 2. Titullarët e angazhuar të lëndëve rezultojnë të kenë gradën shkencore Doktor. 3. Programi është Master Shkencor 4. Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe Drejtuesi i Këshillit Shkencor të programit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH, ndonëse edhe përtej moshës së pensionit; 5. UMSH siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave referuar bisedave me studentët, me stafin akademik të angazhuar dhe formatit të përgatitur për vlerësimin e tyre me notë nga pedagogu përgjegjës dhe personi respektiv në institucionin e praktikës.
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët që ndjekin këtë program studimesh si dhe stafi akademik gjatë takimeve në UMSH konfirmuan se kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Në Bibiloteke verifikuam tezat e përfunduara në vitet e mëparshme akademike. 2. Nga verifikimet e temave të diplomave të depozituara në bibliotekën e UMSH ka raste të udhëheqjes nga pedagogë me Msc të cilët japin mësim si asistentë të titullarit në këtë program Masteri i Shkencave në “Shkenca Politike” dhe tematika lidhet me fushën e tyre të specializimit. 3. Ky kriter plotësohet referuar numrit të studentëve dhe stafit akademik, ku raportet janë më pak se 1:10 për shkencat politike. Mbështetur në Rregulloren e pogramit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike, Lektorët e këtij programi, udhëheqin jo më shumë se 5 studentë përgjatë viteve të studimit deri në përgatitjen e temës së diplomës dhe mbrojtjen e saj. UMSH ka përpiluar Udhëzim për punimin e temës së diplomës në programin e ciklit të dytë dhe një format se çfarë komponentësh duhet të përmbajë ajo dhe se si do të vlerësohet.
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik që jep mësim në Masterin Shkencor në Shkenca Politike bazuar në statutin dhe rregulloren e UMSH si dhe drejtëpërsëdrejti në rregulloren e programit, angazhohet në udhëheqjen e temës së diplomës të studentëve sipas fushave studimore dhe lëndëve që zhvillojnë. Raportet midis studentit dhe udhëheqësit janë të

<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>identifikuara si detyrime dhe përgjegjësi dhe gjenden në rregulloren e programit të studimit. 2. Udhëheqësi për mikrotezën e diplomës ka të paktën gradën shkencore "Doktor i Shkencave" në atë fushë dhe ka angazhime me punë shkencore të provuara me publikime dhe pjesëmarrje në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë UMSH.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>1. Personeli ndihmës mësimor-shkencor angazhohet maksimalisht në vënien në dispozicion sistemet audio-vizive në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare. Ky program nuk ka të parashikuara orë laboratorike. 2. Për realizimin me sukses të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Shkenca Politike është angazhuar në mënyrën më optimale personeli akademik si dhe personeli ndihmës administrativ, i cili u tregua i gatshëm të na vinte në dispozicion të gjitha informacionet dhe bazën e të dhënave.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>1. Përcaktimi i ngarkesës mësimore në UMSH bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në miratimin e planit mësimor për çdo vit akademik me pedagogët përkatës për çdo lëndë, mbështetur në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 20 dhe Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. 2. Ngarkesa mësimore dhe organizimi e drejtimi i tyre për programin e ciklit të dytë të studimit, vlerësohet me orë mësimore, ku çdo pedagog ka rreth 240-270 orë fizike në auditor, ku ora është 50 minuta, sikurse u konfirmua nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe takimet me pedagogët efektive.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>1. Departamenti i Shkencave Politike për programet e studimeve dhe lëndët që zhvillohen në programin e studimit Msc në Shkenca Politike, si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucioni disponojnë një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik dhe mbështetës. 2. Për çdo semestër përcaktohen lëndët dhe orari mësimor, pedagogët e angazhuar, personeli ndihmës dhe ai administrativ. 3. Institucioni në bazë të nevojave që lindin për rekrutimin e personelit akademik publikon kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur nëpërmjet web-site të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", që u verifikua nga bisedat me stafin akademik të rekrutuar që kishin marrë informacionin për aplikim nga web.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen në përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" në përputhje me objektivat dhe strategjinë e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë". Hartimi dhe miratimi i kurrikulës është bazuar në parimet dhe kriteret e Ligjit për Arsimin e Lartë, standardet shtetërore</p>	

të cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, dhe realizuar me pjesëmarrjen aktive të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike, të cilët ishin mëse të familjarizuar me të. Institucioni realizon në mënyrë korrekte dhe transparente procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe mbështetës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren Organizative të UMSH dhe legjislacionin në fuqi. Personeli akademik në këtë program studimi përmbush kriterin e gradës shkencore “Doktor” për të gjithë titullarët e lëndëve. Në fund të çdo viti akademik, Departamenti dhe Dekanati raportojnë për realizimin e objektivave dhe të kualifikimit shkencor i cili konsiderohet pjesë thelbësore e performancës. Studentët që kryejnë studimet në nivelin Masteri i Shkencave, në përgatitjen e temës së diplomës, drejtohen nga një udhëheqës shkencor me njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. UMSH disponon një bazë të hollësishme të dhënash për personelin akademik dhe mbështetës, i cili na u vu në dispozicion nga ZBNJ.

Standardi II.1 përmbushet pasi stafi akademik ishte i familjarizuar me objektivat e programit të shpallura në Strategjinë e tij dhe i angazhuar në zbatimin e tyre.

Standardi II.4 përmbushet pasi kurrikula për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar dhe realizohet nga Departamenti i Shkencave Politike si njësi bazë ku përfshihet gjithë personeli akademik, sikurse rezultoi nga takimet me ta në UMSH.

Standardi III.1 përmbushet pasi UMSH ndjek një procedurë ligjore transparente përmes shpalljes publike fillimisht në web-in e IAL-së) të vendeve të lira për rekrutimin e personelit, duke respektuar kriteret e gradës shkencore Doktor për programin e Masterit Shkencor. Departamenti dhe ZBNJ mban të dhena të përditësuara për vlerësimin e personelit në disa nivele: nga titullarët, nga studentët dhe vetëvlerësimet.

Standardi III.2 përmbushet pasi titullarët e angazhuar të lëndëve rezultojnë të kenë gradën shkencore Doktor në këtë program Masteri Shkencor.

Standardi III.5 përmbushet referuar numrit të studentëve dhe stafit akademik, ku raportet janë më pak se 1 PAE:10 studentë për Masterin Shkencor në Shkenca Politike. Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit Lektorët e këtij programi, udhëheqin jo më shumë se 5 studentë përgjatë viteve të studimit deri në përgatitjen e temës së diplomës dhe mbrojtjen e saj.

Standardi III.6 përmbushet pasi personeli akademik që jep mësim në Masterin Shkencor në Shkenca Politike bazuar në Statutin dhe Rregulloren e programit, angazhohet në udhëheqjen e temës së diplomës të studentëve sipas fushave studimore dhe kanë gradën shkencore Doktor.

Standardi III.7 përmbushet pasi për realizimin me sukses të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Shkenca Politike është angazhuar në mënyrën më optimale personeli ndihmës administrativ me 12 persona.

Standardi III.8 përmbushet mbështetur në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 20 dhe Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike ngarkesa e tyre me 3-4 lëndë shkon deri në 270 orë mësimore, relativisht e lartë, në situatën që stafi akademik angazhohej edhe me detyra administrative.

Standardi III.9 përmbushet pasi Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore na vunë në dispozicion të gjitha informacionet dhe bazën e të dhënave.

Standartet e kësaj fushe institucioni i plotëson plotësisht.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ushtron aktivitetin e tij në një vend të përqëndruar gjë që ndihmon në përdorimin me efektivitet maksimal të ambjenteve, stafit pedagogjik, atij mbështetës, administrativ e të shërbimeve. Godina 4 katëshe pozicionohet në unazën e Tiranës, me kontratë qeraje deri në vitin 2021, që i jep mundësi lëvizjes së studentëve dhe stafit në mënyrë komode duke synuar mospërdorimin e mjeteve individuale të transportit për ruajtjen e ambjentit si dhe lehtësinë e lëvizjes në këmbë, biçikletë ose transport publik. Ajo ka në të dy anet e saj Fakultetin e Shkencave Sociale të UT dhe UET, pra një mjedis studentor të përshtatshëm, që jep mundësi komunikimesh mes studentëve, duke e bërë jetën e tyre më të larmishme. Godina karakterizohet nga ndriçimi

natyral dhe komoditeti e lehtësia e lëvizjes në të gjitha ambjentet duke përfshirë edhe rampat e ashensorët. Godina është e të njëjtit standard në të gjithë shtrirjen e saj, e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi modern gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambjentet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, projektorë, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim bar-restorant, ndihmë të shpejtë, ashensorët të cilët janë të teknologjisë bashkëkohore duke lejuar lehtësisht hyrjen e kujtudo dhe veçanërisht të PAK në të gjithë katet e godinës. Teknologjitë e informacionit, infrastruktura, biblioteka e shërbime të tjera për studentët janë në funksion të tyre e të ofrimit të një shërbimi cilësor në mësimdhënie. Studentëve iu vihet në dispozicion laborator i informatikës dhe sistemi audio-viziv në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Plotësuar Tabelat në Aneks, pas verifikimit të tabelave të paqyruara në RVB)

- Salla për leksione (6 me kapacitet 100-120 vende)
- Klasa për seminare (15 me kapacitet 30-45 vende)
- Salla për aktivitete promovuese (2)
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale (1)
- Laboratorë për lëndët- Nuk ka punë laboratorike
- Laboratorë informatike (1)
- Salla interneti -Interneti është i aksesueshëm në gjithë mjediset e UMSH
- Salla për bibliotekë (1)
- Mjedis për fotokopjime, librari etj (1)
- Zyrë informacioni për studentët (1)
- Nyje hidrosanitare (ka në çdo kat së paku dy)

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin - po, mjedise të veçanta për Dekanin dhe Kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore - po sekretaria mësimore ndodhet në hyrje të godinës qendrore, lehtësisht e aksesueshme prej stafit dhe studentëve
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore - po ka zyra për çdo departament ku u qendrua gjatë takimeve me stafin akademik
- Zyra për personelin akademik - po ka zyra me tavolina e kompjutera për PAE.

Infrastruktura në funksion të programit të studimit e konstatuar në institucion me një vizitë nëpër mjediset e lartpërmendura, përgjithësisht përputhet me atë të pasqyruar në RVB. Ka mjedise të përshtatshme për këtë program studimi dhe numrin e studentëve që e kanë ndjekur programin gjatë periudhës 2012-2018, të cilë kanë qenë nga 10-19 studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p>	<p>1. Institucioni e zhvillon veprimtarinë e tij në një godinë moderne 4 katëshe me mjedise të bollshme dhe të pajisura mirë për qëllimin e institucionit dhe funksionale në qendër të Tiranës në Bulevardin “Gjergj Fishta”, shumë lehtë i aksesueshëm.</p>
<p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p>2. Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet, ka një kontratë qeraje deri në 2021;</p>
<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>3. Në realizimin sa më efektiv të programeve të studimit dhe shfytëzimin maksimal të godinës që disponon universiteti, programet e studimit Master zhvillohen gjatë ditëve të javës nga ora 17-20, si dhe të shtunave nga ora 9-17, duke lehtësuar pjesëmarrjen e studentëve që shumica janë të punësuar.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>4. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p>

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>1. Institucionin ka siguruar në Bibliotekën e tij tekste mësimore dhe literaturë të mjaftueshme dhe bashkëkohore, duke bashkëpunuar me libraritë për titujt e rinj që hyjnë çdo vit. Po ashtu, çdo pedagog depoziton në Bibliotekë tekstet bazë ose leksione të shtypura për studentët.</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>2. Në bibliotekë ka një literaturë të pasur përsa i përket nevojave të 10-19 studentëve që e kanë ndjekur programin gjatë periudhës 2012-2018 dhe të pedagogëve për kërkimin shkencor në shkencat ekonomike, juridike dhe politike. Aty janë të depozituara edhe tezat e studentëve të Masterit Shkencor të viteve të mëparshme që u shërbejnë si pika referimi studentëve të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>3. Në UMSH ofrohet mundësia për akses në bibliotekën online Questia si edhe në Revistën e përjavshme The Economist. Krijimi i UMSHPress dhe revistës shkencore periodike EUROMEDITERRANEAN, fondi i pasur i bibliotekës që kishte të regjistruar 4054 tituj librash dhe mbi 15,000 libra fizike dhe një bibliotekare të dedikuar mundësojnë realizimin me sukses të programit të studimit dhe të projekteve kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>4. Biblioteka furnizohet rregullisht me tituj të rinj, sipas kërkesave të pedagogëve çdo vit dhe donacioneve nga bashkëpunëtorët.</p>
<p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>5. Orari i mundësisë për të aksesuar në bibliotekë është i afishuar dhe në përputhje me kohëzgjatjen e orarit në të cilin UMSH rezulton i hapur. Informacioni aksesohet në: www.Umsh.edu.al/fakultetet/shërbime/biblioteka</p>

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

1. Institucioni vendos në dispozicion të studentëve të gjithë ambjentet e tij që janë të përshtatshme për realizimin e programit Master Shkencor në "Shkenca Politike", me klasa të bollshme për 10-19 studentë që kanë ndjekur këtë program gjatë periudhës 2012-2018, me pajisje të teknologjisë së informacionit për realizimin e leksioneve, filmave, dhe zyrave për pedagogët.

2. Pajisjet informatike iu shërbejnë stafit për mësimdhënie dhe studentëve në kryerjen më së miri të detyrave të kursit dhe të nevojave të tjera didaktike që ata mund të kenë.

3. Ka një laborator për aksesin në internet dhe punën në kompjuter që është i përshtatshëm me software-ët e nevojshëm për plotësimin e kërkesave të këtij programi studimi.

4. Institucioni e ka zgjidhur më së miri çështjen e praktikave, duke i trajnuar më parë studentët në ambjentet e tij nëpërmjet zyrës së punës Headhunter, e më pas duke i dërguar në institucione të tjera me të cilët ka bashkëpunime në këtë drejtim. Programi Master i Shkencave në "Shkenca Politike" nuk parashikon praktika laboratorike.

Konkluzionet e vlerësimit:

UMSH është një institucion që sa i takon infrastrukturës, përmbush plotësisht standardet për studentët dhe stafin akademik në realizimin me sukses të programit të studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë pajisur në respekt të plotë të të gjitha kërkesave dhe standarteve shtetërore të cilësisë, me klasa të bollshme dhe të pajisura më së miri. Laboratori informatik, biblioteka me mbi 4000 tituj librash të cilët shtohen në çdo vit akademik, aktivitetet në funksion të studentëve me salla konferencash, mjedise dhe zyra pune të stafit akademik dhe administrative i shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në katin -1 të godinës dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studjuesit. Biblioteka siguron literaturë të mjaftueshme në fushën e shkencave sociale, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.

Standardi II.5 plotësohet pasi institucioni e zhvillon veprimtarinë e tij në një godinë moderne 4 katëshe me mjedise të bollshme dhe të pajisura mirë për qëllimin e institucionit dhe funksionale në qendër të Tiranës në Bulevardin "Gjergj Fishta", shumë lehtë i aksesueshëm.

Standardi V.1 plotësohet pasi institucionin ka siguruar në Bibliotekën e tij tekste mësimore dhe literaturë të mjaftueshme dhe bashkëkohore, si dhe librarinë online Questia.

Standardi V.2 plotësohet pasi institucioni vendos në dispozicion të studentëve të gjithë ambjentet e tij që janë të përshtatshme për realizimin e programit Master Shkencor në "Shkenca Politike", me klasa të bollshme për 10-19 studentë që kanë ndjekur këtë program gjatë periudhës 2012-2018, me pajisje të teknologjisë së informacionit për realizimin e leksioneve, filmave, dhe zyrave për pedagogët.

Standardet e kësaj fushe institucioni i plotëson plotësisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka nisur si projekt i OJF "Qendra Mesdheu" regjistruar me Vendim Nr. 411 datë 06.07.2007 në Gjykatën e Tiranës si person juridik me objekt të aktivitetit, shërbimet në fushën e arsimit të lartë privat dhe kërkimit shkencor. Referuar nenit 24 të Statutit dhe nenit 15 të Rregullores Organizative të UMSH, Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i "Qendra Mesdheu" është autoriteti i cili emëron anëtarët e Bordit të Administrimit, duke iu pergjigjur edhe kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë në RSH, nr.80/2015.

Rezultatet e financimit, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohen në pasqyrat financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Burimet e financimit janë rritur prej tarifës së studentëve, numri i të

cilëve ka ardhur në rritje, duke bërë që pjesa kryesore e financimeve të trefishohet në 6 vjetët e fundit. Burim financimi duket se janë edhe aktiviteti bar-restorant në brendësi të godinës së UMSH dhe konsulentat apo grantet, të cilat natyrisht që pritet të kenë një peshë specifike më të madhe në një universitet në të ardhmen.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje)

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi në përqindje i janë referuar Tabelës nr.5 në aneks, që për vitin akademik 2017-2018 ato paraqiten si më poshtë:

- Grantet për kërkim (5%)
- Konsulentat, shërbimet (0%)
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit (85%)
- Sponsorizimet (0%)
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) (0%)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj., (0%)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) (10%)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar të dhënave në Tabelën nr. 5/1 në aneks, kostoja për student në UMSH ka ndryshuar ndër vite, duke arritur në koston më të ulët në vitin akademik 2015-2016, e lidhur kjo me numrin më të lartë të studentëve. Pavarësisht rritjes së koston në vitin akademik 2017-2018 në 137.000 lekë për student, UMSH ka mundur të ofrojë disa bursa për studentët dhe të ketë tarifa konkurruese për regjistrimin e studentëve në Master Shkencor, krahasuar me IAL e tjera në vend. Në këto kushte, mund të thuhet se kapacitetet menaxhuese të UMSH në këtë drejtim janë relativisht të kënaqshme, pasi ka mundësira për rritjen dhe diversifikimin e burimeve të financimit prej bashkëpunëtorëve dhe projekteve kërkimore, me stafin e kualifikuar dhe infrastrukturën që zotëron.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>1. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren Organizative UMSH, neni 32.</p> <p>2. Situata financiare e Institucionit ka pasqyron vetëm 5% të granteve të përfituara nga kërkimi shkencor, pjesa tjetër mbulohet nga tarifat studentore të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të realizimit të programit të studimit.</p> <p>3. Në mënyrë periodike, Bordi kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve duke e përvijuar në mënyrë eksplicite drejtimin e saj në eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve që zenë 85% të të ardhurave. Përmirësimi i stafit akademik, investimet infrastrukturore të rëndësishme që lidhen</p>

	me kushtet e punës dhe mesimdhënien, shtimi i fondit të bibliotekës janë indikatorë të përdorimit të fondeve të UMSH.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>1. Zyra për Kontabilitet dhe Financë, përgjegjëse për aktivitetin financiar dhe menaxhimin e fondeve në UMSH, harton raportin me të ardhurat dhe shpenzimet e detajuara për çdo vit.</p> <p>2. Pasqyrat financiare të Institucionit pasqyrojnë gjendjen financiare të tij e cila jep siguri për vazhdimësinë e aktivitetit të institucionit. Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertët e jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Crowe Horwath AL shpk. (RVB, faqe 31). Nga qendrueshmëria dhe rritja e stafit akademik dhe nga bisedat me ta dhe studentët u reflektua kjo siguri financiare e UMSH.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>UMSH është projekt i OJF Qendra Mesdheu dhe në bazë të statutit harton raporte të përvitshme financiare të detajuara të cilat i paraqiten Bordit të Administrimit në çdo vit, duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare në gjenerimin e të ardhurave dhe vijueshmërisë së aktivitetit. Zyra për Kontabilitet dhe Financë është përgjegjëse për aktivitetin financiar, menaxhimin e fondeve dhe raportimet në këtë IAL. Aktiviteti i saj auditohet për çdo vit si së brendshmi, ashtu edhe së jashtëmi sipas legjislacionit në fuqi. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31. Në mënyrë periodike, Bordi kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve duke e përvijuar në mënyrë eficientë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve që zenë 85% të të ardhurave. Përmirësimi i stafit akademik, investimet infrastrukturore të rëndësishme që lidhen me kushtet e punës dhe mesimdhënien, shtimi i fondit të bibliotekës janë indikatorë të përdorimit të fondeve të UMSH. Në këto kushte, mund të thuhet se kapacitetet menaxhuese të UMSH në këtë drejtim janë relativisht të kënaqshme, pasi ka mundësira për rritjen dhe diversifikimin e burimeve të financimit prej bashkëpunëtorëve dhe projekteve kërkimore, me stafin e kualifikuar dhe infrastrukturën që zotëron.</p> <p>Standardi II.9 përmbushet pasi auditi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren Organizative UMSH, neni 32.</p> <p>Standardi VI.1 përmbushet pasi Zyra për Kontabilitet dhe Financë, përgjegjëse për aktivitetin financiar dhe menaxhimin e fondeve në UMSH, harton raportin me të ardhurat dhe shpenzimet e detajuara për çdo vit.</p>	
Instituoni i plotëson standardet plotësisht.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Për të garantuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, UMSH me statusin e Universitetit tashmë ka ngritur një strukturë të përhershme kryesore si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Veprimtaria e saj, jo vetëm synon të monitorojë përputhshmërinë e aktivitetit mësimor e kërkimor të UMSH me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore të UMSH, por gjithashtu arritjen e

Maso

objektivave strategjike dhe misionit të tij. Ky përbën një ndryshim institucional krahasuar me situatën gjatë akreditimit të parë ku kishte komisione të ngritura ad hoc për monitorimin e sigurimit të cilësisë. Senati Akademik miraton Manualin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili iu vjen në ndihmë edhe njësive kryesore dhe bazë që janë përgjegjëse për organizimin e programit Master Shkencor në Shkenca Politike. NJSBCZHK përdor forma të larmishme kontrolli të cilësisë së mësimdhënies, rritjen e performancës akademike të stafit akademik dhe atij me kontratë. Për këtë qëllim, ajo në mënyrë periodike ndërthur forma të vetëvlerësimit me ato të vlerësimit të jashtëm nga titullarët dhe studentët.

NJSBCZHK ka 7 anëtarë të caktuar nga Nëntori i vitit 2017, ku drejtuesja dhe 5 anëtarë janë staf akademik i brendshëm i UMSH, ka një përfaqësues të stafit administrativ dhe një student.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBCZHK për programin e studimit:

Nga takimi me anëtarët e NJSBCZHK në UMSH, stafin akademik dhe studentët konfirmohen të dhënat e RVB në lidhje me indikatorët e mëposhtëm për vlerësimin e standardeve të cilësisë.

- Sa anketime kanë bërë me studentët
Zakonisht kryhen 2 anketime në çdo vit akademik me studentët, përkatësisht në fund të semestrit për lëndët e zhvilluara gjatë atij semetri.
- Sa studentë janë anketuar
Anketimi kryhet para sezonit të rregullt të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët që janë prezentë dhe dëshirojnë të plotësojnë anketën. Studentët në takimin në UMSH konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në anketimin e zhvilluar në fund të semestrit të parë.
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
NJSBCZHK përpunon vetëm ato anketime ku numri i të anketuarve kalon 25% të frekuentuesve të rregullt të lëndës, përndryshe anketa nuk merret në konsideratë për t'u përpunuar. Problematikat i bëhen të njohura stafit akademik dhe studentëve.
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
NJSBCZHK zhvillon anketime periodike sipas një plani kalendarik në të cilin programohen vlerësimet që shoqërohen me raporte me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, anketimet e përpunuara, së bashku me raportin e vetëvlerësimit, i kalojnë Rektoratit dhe Dekanatit të cilët zhvillojnë takime konfidenciale me të gjithë stafin e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBCZHK informon në mënyrë periodike Dekanatin, Rektoratin mbi rezultatin e përpunimit të anketimeve dhe raportit të vetëvlerësimit të stafit dhe të vlerësimit të titullarit. Ballafaqimi mes këtyre hallkave shkon në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe performancës së stafit. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e personelit akademik mbi metodikën e mësimdhënies. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin edhe në njohjen e specifikave të rregulloreve të UMSH dhe në aspekte të organizimit të mësimin.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë në nivel universiteti janë sipas strukturës hierarkjike organizative të UMSH. Struktura e krijuar posaçërisht gjatë këtij viti akademik 2017-2018 për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë është NJSBCZHK e cila ka në përbërje të saj staf akademik dhe studentë. Drejtuesja e kësaj njësie është edhe drejtuese e Këshillit Drejtues të Programeve Bachelor dhe Master Shkencor në Shkenca Politike. Ka edhe një tjetër staf akademik e programit Master Shkencor në Shkenca Politike, nga Departamenti i Shkencave Politike. Këto të dhëna tregojnë që programi Msc. në Shkenca Politike e ka probabilitetin të lartë që të zbatohet me rigorozitet monitorimin e

standardeve të cilësisë në hartimin e kurrikulave dhe syllabuseve, si edhe në zbatimin korrekt të tyre.

Zyra e Burimeve Njerëzore përmes Formularit të Performancës realizon vlerësimin e personelit akademik sipas hierarkisë, ku Dekani vlerësohet nga Rektori, Përgjegjësi i Departamentit nga Dekani, Pedagogët nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe personeli akademik japin vlerësime horizontale për njeri tjetrin dhe duke plotësuar formularët e vetëvlerësimit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet e kryera u verifikuan përmes vënies në dispozicion të formularit të vetëvlerësimit dhe pasqyrimin në dosjet e personelit të aktivitetit shkencor të çdo pedagogu. Gjatë vitit akademik 2017-2018, NJSBCZHK është marrë specifikisht me adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve nga vlerësimi i jashtëm institucional i bërë gjatë vitit akademik 2016-2017.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit në mënyrë periodike synohet që personeli akademik të ndërjegjësohet mbi punën dhe performancën e tij dhe për reflektimin në marrëdhëniet me studentët. Ndër tematikat më kryesore nga rezultatet e vlerësimit të personelit akademik kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimin, cilësinë në shpjegim dhe format e kontrollit të dijeve. NJSBCZHK rezulton të funksionojë duke ruajtur privatësinë, por edhe duke nxitur përmirësimin, ndonëse ky ishte viti i parë i krijimit të kësaj strukture të konsoliduar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në institucion na u vu në dispozicion një model formulari vetëvlerësimi dhe një përlllogaritje e performancës të pedagogëve nëpërmjet tabelës së pikëzimit, si dhe një model pyetësori i studentit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p>	<p>1. Institucioni kryen në mënyrë të rregulltë vlerësimin e punës për ecurinë e programeve të studimeve, nëpërmjet metodave të tërthorta e të drejtpërdrejta.</p> <p>2. Rezultatet e vlerësimit përmbledhen në raportin vjetor të NJSBCZHK-së, i cili iu dërgohet Dekanëve përkatës dhe Rektorit.</p> <p>3. Njëherazi, u referohen pedagogëve pikëzimet përkatëse dhe rekomandohen detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBCZHK.</p> <p>4. Metodatat e vlerësimit të tërthorta dhe të drejtpërdrejta janë kombinuar sipas rastit.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. anketime të studentëve për të gjitha lëndët dhe stafin e tyre akademik. Rezultatet i vihen në dispozicion vetë pedagogut, drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve, si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>b. Përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve si kalueshmëria për lëndë,</p>

<p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>nota mesatare, etj., të cilat mbahen në sekretarinë mësimore.</p> <p>c. Rezultatet e testeve, detyrave dhe provimeve të studentëve.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Përgjegjësi i Departamentit realizon dëgjime në auditor të zhvillimit të mësimit dhe vëzhgime të praktikës.</p> <p>b. Cilësia e mikrotezës dhe realizimi në kohë.</p> <p>c. Vlerësimet e veprimtarive kërkimore, botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca.</p> <p>d. Vlerësimet e pedagogëve nga kryetari i gruplëndëve sipas formatit tip në dokumentin nr.16 të hedhur në sistem.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>1. UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese dhe pedagogëve.</p> <p>2. UMSH ka një faqe interneti të pasur me informacione të veprimtarive të tij, si dhe ka publikuar raportet e vlerësimit të jashtëm nga vitit 2012, por jo raportet e vlerësimit të brendshëm.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>1. NJSBCZHK përgatit raportin vjetor të vlerësimit të ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë që përdoret si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë akademike; mësimdhënie-mësimnxënies dhe performancën e programit në lidhje me tregun nga Departamenti dhe njësitë e tjera të UMSH.</p> <p>2. Propozimet e NJSBCZHK shqyrtohen nga njësitë dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në përmirësimin e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës, opinionin e studentëve dhe të personelit akademik.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni i ka plotësuar standartet institucionale, sidomos pas akreditimit institucional nga agjencia britanike të realizuar përgjatë vitit 2017, përpara aplikimit për riakreditimin e programit. 2. Zyra e NJSBCZHK është aktive përgjatë të gjithë vitit akademik, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe rekomandimeve për përmirësimin e kurrikulave dhe të planeve mësimore. 3. Institucioni zotëron tashmë një plan pune vjetor për sigurimin e cilësisë së tij të brendshme. 4. Institucioni përdor kryesisht mekanizma formalë, përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBCZHK, tërheqjes së mendimit të studentëve, të studentëve të punësuar dhe bashkëpunimit me ASCAL. 5. Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UMSH me fillimin e vitit akademik, si dhe gjatë vitit në takime me drejtuesit e institucionit dhe administratorët. 6. UMSH ka arritur të ketë një Manual të Sigurimit të Cilësisë dhe të aplikojë elementë të tij në rregulloret e brendshme.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>UMSH i kushton një vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë në çdo hallkë të procesit mësimor e kërkimor. Konsolidimi dhe ristrukturimi i Komisionit ad hoc të Sigurimit të Cilësisë në njësinë e veçantë NJSBCZHK me staf akademik me përvojë në menaxhimin e IAL dhe me studentë është tregues i vëmendjes ndaj cilësisë. Anketimet periodike të studentëve, vlerësimet sipas hierarkisë administrative nga ZBNJ dhe vetëvlerësimet e stafit akademik janë tregues të rëndësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për arritjen e objektivave të programit të studimit. Hartimi i planit vjetor të punës, rregulloreve të brendshme dhe manualeve e lehtëson këtë proces dhe kanë ndikuar në ndërgjegjësimin e stafit për respektimin e standardeve të cilësisë.</p> <p>Standardi I.10 përmbushet pasi u konsultuam me formatet e vlerësimit si nga studentët, edhe nga titullarët për stafin akademik, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.</p> <p>Standardi I.13 përmbushet pasi UMSH ka një faqe interneti të pasur me informacione dhe ka publikuar raportet e vlerësimit të jashtëm nga vitit 2012, por jo raportet e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Standardi II.7 përmbushet pasi NJSBCZHK përgatit raportin vjetor të vlerësimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë që përdoret si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.</p> <p>Standardi VIII.1 përmbushet pasi institucioni zotëron një plan pune vjetor për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie shumëdimensionale, standardi rezulton plotësisht i plotësuar.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" ka si objektiv thellimin e njohurive të përfituara nga të diplomuarit e nivelit Bachelor, fitimin e aftësive dhe kompetencave me synimin që të jenë të gatshëm të pozicionohen në karrierën e tyre profesionale, si dhe për të vazhduar më tej studimet e avancuara të doktoraturës. Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike", i pajis studentët me njohuri dhe aftësi e kompetenca bashkëkohore në shkencat politike nëpërmjet disiplinave si:

- Metodatat e kërkimit shkencor,
- Njohuri të thelluara për studimin e grupeve dhe institucioneve të shoqërisë,
- Njohuri të thelluara mbi krahasimin e sistemeve politike,
- Globalizimi, lëvizjet sociale dhe politikatat sociale,
- Analizë politike,
- Liberalizmi, (zevendësuar)
- Socialilizmi, (zevendësuar)
- Teoritë e shtetit,
- Sistemet politike dhe partitë politike në Shqipëri,
- Barometri elektoral dhe sondazhet e opinionit publik, (zevendësuar)
- Komunikimi politik,
- Institucionet dhe administrata e BE-se.

Kurrikula e programit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është bashkëkohore, ambicioze dhe në përmirësim të vazhdueshëm. Angazhimi i një stafi me përvojë dhe me grada shkencore bën të mundur realizimin konkret të përcjelljes së dijeve tek studentët përgjatë dy semestrave të dy viteve akademike. Kërkimit shkencor është prioritet i personelit akademik dhe institucioni krijon kushtet e nevojshme për përmbushjen e tij në semestrin e fundit që i dedikohet praktikës dhe përgatitjes së temës së diplomës. Programet e studimit shoqërohen me botime, literaturë bazë dhe ndihmëse e cila gjëndet në bibliotekën e UMSH. Rëndësi i kushtohet informimit të studentëve që në javën e parë të fillimit të vitit akademik dhe në vazhdimësi mbi programet e studimit, kohëzgjatjen e tyre, kreditet, lëndët, orarin mësimor, mjediset të cilat janë të organizuara konform standardeve shtetërore të cilësisë dhe sistemit të krediteve të Bolonjës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Fillimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" daton nga viti 2011, i hapur në bazë të Urdhërit nr. 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Akredituar me Urdhërin nr. 291 datë 11.07.2012. Programi i orienton studentët për një edukim cilësor të qendrueshëm me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim shkencor të thelluar, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, duke i aftësuar ata për të zotëruar dije në fushën e shkencave politike duke i orientuar në kompetencat që kërkon stadi i zhvillimit strategjik të vendit. Objektivat e programit janë të përgatisë politologë, administratorë dhe funksionarë publikë, të aftë për të kontribuar në zhvillimin politik të vendit, në emancipimin e klasës politike, si edhe në modernizmin e administratës publike në Shqipëri, si dhe përgatitjen e kapaciteteve njerëzore, analistëve, studjuesve të shkencave politike të aftë për bashkëpunime rajonale që tashmë UMSH i ka institucionalizuar. Programi Master Shkencor në "Shkenca Politike" vijon thellimin e mëtejshëm të dijeve mbështetur në formimin bazë realizuar në nivelin Bachelor në "Shkenca Politike", por jo vetëm, pasi studentët vijnë me njohuri teorike dhe praktike nga fusha të ndryshme studimi.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. (Referoju Tabelës nr. 7 të Planit në aneks)

Plani mësimor Master i Shkencave në "Shkenca Politike" (referuar RVB Tabela 10 faqe 41; RVJ, Tabela nr. 7 Aneks) ka të organizuara mirë ndarjen e lëndëve për vitin e parë dhe të dytë. Në plan pasqyrohet qartë ndarja e ECTS sipas semestrave dhe viteve, ku viti akademik llogaritet me 60 ECTS. Sa i takon shpërndarjes së lëndëve, që në fillim është vendosur lënda e metodave të kërkimit, e nevojshme për të realizuar detyrat e kursit dhe tezën e diplomës. Plani mësimor duket i ngurtësuar, pasi as në vitin e parë dhe të dytë nuk janë paraqitur lëndë me zgjedhje, duke mos përmbushur skemën formale të kompozimit të planit mësimor si dhe një nga rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. Vetëm në 2018 (referuar Shkresës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.2752/1, datë 24.04.2018 ku titulli i Masterit ndryshon, në programi mësimor ka tre lëndë të zëvendësuar: Liberalizmi, Socializmi dhe Barometri elektoral dhe Sondazhet e Opinioneve Publik. Praktika ka 15 kredite, që zhvillohet në 6 javë për semestrin e dytë, ndërsa Mikroteza ka 20 ECTS, nuk ka ndryshuar, ndonëse sipas standardeve të cilësisë mikroteza duhet të ketë minimalisht 30-40 kredite. Totali i orëve të leksioneve në auditor është relativisht më i lartë sesa i orëve në auditor të seminareve, ndërkohë që parashikohen më shumë orë në auditor për praktikën, kjo duket sikur nuk qëndron. Nga takimet me drejtuesit dhe stafin e departamentit na u shpjegua se Praktika tani është një lëndë që vlerësohet me notë si gjithë të tjerat, (më parë ka qenë pa notë). Ajo realizohet nga profesionistë që merren me drejtimin e agjencive të punësimit, duke aftësuar studentët të orientohen në tregun e punës. GVJ sugjeron të rishikohen raportet për orët në auditor të Praktikës që për një ECTS ka 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur, në favor të orëve jashtë auditorit. Sa i takon formave të mësimdhënies leksion-seminar për çdo lëndë kreditet janë llogaritur për orët e mësimit në auditor e jashtë auditorit, si punë e pavarur e studentit, e cila ka një peshë specifike pak më të lartë.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Leksionet	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Seminaret	11 orë në auditor dhe	14 orë punë e pavarur e studentit
▪ Labororet	----orë në auditor dhe	-----orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën lëndore	___ orë në auditor dhe	___ orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën Profesionale	21 orë në auditor dhe	4 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	1 orë në auditor dhe	24 orë punë e pavarur e studentit

Përcaktimi i ndarjes së krediteve të një lënde përcaktohet si për orët e leksioneve dhe ato të seminareve, ku ndryshimi është i vogël në lidhje me orët që harxhohen në auditor për leksionet dhe seminaret. Në një program Masteri Shkencor studentët duhet të fitojnë kompetenca dhe aftësi për kërkim shkencor të pavarur, që të finalizojnë temën e diplomës, prandaj puna e pavarur e studentit duhet të kishte një ngarkesë më të madhe në krahasim me orët në auditor. UMSH ka realizuar një zgjidhje të mirë duke e organizuar mësimin mbasditeve, 17:00-20:00 dhe të shtunave gjatë gjithë ditës, pasi një pjesë e mirë e studentëve janë të punësuar.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësuar Tabela në Aneks)

Ndryshimet në planet mësimore janë parashikuar të realizohen dhe propozohen nga Departamenti deri në 15 Maj të çdo viti akademik, duke kaluar në miratim nga Dekanati dhe Senati i UMSH. Megjithatë plani mësimor duket i ngurtësuar, pa ndryshime në 6 vite akademike nga 2012-2017. Po ashtu ka mungesë fleksibiliteti referuar faktit që nuk ka të parashikuara lëndë me zgjedhje. Nga bisedat me stafin akademik të diplomuar në universitetet evropiane u theksua se kryesisht viti i parë ka lëndë bazike të fushës së studimit dhe në vitet në vijim ka opsione lëndësh me zgjedhje. Po ashtu, edhe nga diskutimet me studentët u evidentua nevoja për më

tepër lëndë me zgjedhje, veçanërisht në fushën e njohurive ekonomike, pasi një pjese të studentëve u lidhje me punësimin e tyre.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotësuar Tabela nr. 8 në Aneks)

Referuar Tabelës nr.8 në aneks dhe takimeve me stafin akademik në UMSH, duket qartë një lidhje e ngushtë mes kualifikimit të stafit akademik dhe lëndëve të përcaktuara në planin mësimor. Personeli akademik efektiv mbulon pothuajse gjithë programin Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, ku përfshihen pedagogë edhe nga Fakulteti Juridik dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program mban gradën shkencore Doktor konform kërkesave të Ligjit 80/2015. Përjashtim bëjnë dy lëndë që asistentë pedagogë janë me Msc, që justifikohen si në rastin e personelit akademik të jashtëm K.Gj si ish Ministre e Integritit Evropian për lëndën Institucionet e BE. Sikurse në këtë lëndë, edhe në gjithë lëndët e tjera, Departamenti i ka kushtuar vëmendje lidhjes së ngushtë mes formimit akademik të personelit akademik me lëndët përkatëse që ata zhvillojnë. Realizimi i planit mësimor me pjesëmarrjen e pedagogëve nga departamente të tjera është një zgjedhje e mirë, pasi dihet që stafi akademik i brendshëm është më i përgjegjshëm në përmbushjen e objektivave dhe standardeve të cilësisë.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset e lëndëve janë standard nga forma dhe në krye të tyre në dokumentin e UMSH të hedhur në sistemin e ASCAL ishte Vendimi i Departamentit i Tetorit të çdo viti akademik për miratimin e syllabuseve që ishin hartuar në Shtator të po atij viti. Në hyrje të syllabusit jepet një përshkrim i përgjithshëm i lëndës, detajohet ngarkesa në kredite si dhe përcaktimi nëse lënda është e detyrueshme apo lëndë me zgjedhje. Element bazë i syllabuseve janë objektivat e lëndës, të cilat shpjegojnë mënyrën sesi studentët do të pajisen me njohuritë e duhura për atë çfarë lënda ka në përmbajtjen e saj. Elementë të tjerë janë format dhe metodat e mësimdhënies, duke filluar me leksionet në auditor, leksionet e hapura me personalitete dhe ekspertë të fushave të caktura, diskutime, debate gjatë seminareve të programuara. Komponenti i fundit i syllabusve është ndarja e temave që do të trajtohen çdo javë si dhe literatura e përdorur. Secila temë është e ndarë në nëntema mbi të cilat zhvillohet trajtimi teorik i ndërthurur me praktikën. Nga vizita në UMSH kuptuam që stafi akademik ishte i familjarizuar me kërkesat e formatit të ri të vitit 2018 nga Ministria e Arsimit për standardizimin e syllabuseve, me të cilat ishin angazhuar t'i rimodelonin. Ndoshta jo me renditjen e mësipërme, por të gjithë elementët e kërkuar më lart janë të pasqyruar në syllabuse. Në faqen e parë ku ishte titulli i lëndës dhe titullari, GVJ sugjeron të vendosen edhe kontaktet e tij që mungonin në të gjitha syllabuset.

Formatimi i tyre mbante këtë renditje:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Përshkrimi i Lëndës

- Objektivat
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Format e vlerësimit të studentëve
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik

Fakti që syllabuset miratohen çdo fillim viti nga Departamenti dhe që ato rishikohen çdo vit, sipas bisedës me stafin akademik, është një përvojë e mirë e UMSH. Duke u njohur me çfarë tematikash trajtohen në syllabuse të ndryshme, profesorët shmangin përsëritjet e panevojshme dhe bëhen kompletarë në njohuritë që ofron çdo lëndë.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Ndërsa forma e syllabuseve është e njejtë, në përmbajtje ato ndryshojnë nga njëri-tjetri në varësi të lëndëve dhe specifikave që secila prej tyre. Analiza e cilësisë së syllabuseve realizohet mbi bazën e diskutimeve të veçanta që u bënë gjatë vizitës në UMSH me të gjithë personelin akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, të cilët ishin të familjarizuar me lëndët e tyre dhe të orientuar për të përfshirë në syllabuse informacione të fundit të lidhura edhe më punën e tyre kërkimore post doktorale. Po ashtu, nga diskutimi me studentët kuptuam që këto elementë të syllabusit nuk ishin thjesht formale, por ato zbatoheshin në procesin mësimor, duke realizuar një aktivizim të studentëve në grupe të vogla dhe diskutime në auditor me të ftuar mbi çështje aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare, si pjesë e metodave interaktive së punës së pedagogut. Ngarkesa mësimore është pjesë detyruese e komponentëve të syllabusit, në të cilën realizohet përputhja e orëve mësimore me ato të përcaktuara në programet mësimore. Detyrimet për studentin janë gjithashtu të përcaktuara në syllabus me qëllimin, që të mundësohet informimi i studentëve mbi detyrimet që ata kanë kundrejt lëndës. Forma e vlerësimit të studentëve duket e unifikuar për të gjitha lëndët, duke e ndarë vlerësimin në përqindje: konkretisht 60% të lëndës e përbën nota përfundimtare; 25-30% punimi i eseve dhe 10-15% frekuentimi në leksione dhe seminare. Një përqindje më e madhe mund t'i lihet vlerësimit të studentëve mbi bazën e frekuentimit dhe pjesëmarrjes aktive, që të jenë prezentë gjatë të gjitha orëve në auditor. Kjo do të ishte në përputhje edhe me Rregulloren e UMSH ku pjesëmarrja në ndjekjen e leksioneve dhe seminareve duhet të jetë në masën 75% të lëndës, e referuar në çdo syllabus, ndërkohë që ky element nuk mund të përbëjë vetëm 10% të vlerësimit. Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse me botime të autorëve vendas e të huaj është nga pikat më të forta në përmbajtjen e syllabuseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumenti i UMSH, Shkresa nr. 355, datë 12.03.2018 për ndryshimin e emërimit të programit Msc. në "Shkenca Politike" në Msc. në "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit" me dokumentacionin shoqërues si plani mësimor i ndryshuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	1. Programi Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është akredituar për herë të parë në vitin 2012 dhe ky është riakreditim. Programi organizohet në module dhe i vlerësuar në kredite, (ECTS) të detajuara madje për leksionet dhe seminarët brenda një lende;
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të	

<p>grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>2. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite për vitin e parë dhe 60 ECTS për vitin e dytë dhe në total 120 ECTS, duke respektuar standardet shtetërore.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>2. Programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Politike i pajis studentët të cilët zotërojnë diplomën Bachelor me njohuri të thelluara teorike dhe i ndihmon ata në kërkimin shkencor. Gjatë ciklit të studimeve studentët angazhohen në kërkime shkencore që udhëhiqen nga pedagogët e fushës, duke përdorur literaturën e bibliotekës, Questia online, sipas referencave nga pedagogët dhe punës së pavaruar në përgatitjen e temës së diplomës, tema që u konsultuan gjatë vizitës në bibliotekën e UMSH.</p> <p>3. Objektivi i këtij programi bazuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është t’i pajisë studentët me njohuri të thelluara teoriko-aplikative, referuar programit dhe syllabuseve të lëndëve, si dhe diskutimeve me studentët e stafin.</p> <p>4. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p> <p>5. Qëllimi dhe misioni i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është, jo vetëm të zgjerojë njohuritë teorike të studentëve, por t’i pajisi me kompetenca dhe aftësi sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, niveli 7.</p> <p>6. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” synon t’i orientojë studentët në vazhdimin e studimeve të mëtejshme të ciklit të tretë të doktoraturës, të cilat mundësohen në kushtet e ndryshimit të statusit të këtij institucioni nga Shkollë e Lartë në Universitet.</p> <p>7. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për</p>	<p>1. Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është jo vetëm të zgjerojë njohuritë teorike të studentëve, por t’i pajisi me aftësi përmes orëve të seminareve e punës së pavarur, dhe veçanërisht lëndës së Praktikës, si dhe kompetenca përmes punimit detyrave të lëndëve dhe finalizimit me studimin e mikrotezës së diplomës.</p> <p>2. Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve dhe aftësive arsyetuese, argumentuese dhe kritike të studentëve të UMSH bëhet nëpërmjet provimeve me shkrim e gojë dhe formave të ndryshme të testeve dhe eseve apo detyrave të kursit, sipas përcaktimit në</p>

ciklin përkatës të studimeve.	syllabuset e programit.
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>1. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar duke u mbështetur në eksperiencat e universiteteve evropiane me të cilat universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi dhe universiteteve nga janë diplomuar një pjesë e stafit akademik.</p> <p>2. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është ndërtuar mbi bazën e frymës së programeve të studimeve Evropiane dhe sistemit të Bolonjës. Ky aspekt është i dukshëm në përmbajtjen e programit dhe të syllabuseve të lëndëve, sistemit të ECTS, duke mundësuar transferimin e studentëve nga universitet evropiane të Italisë e Greqisë apo aplikimin e studentëve të UMSH në programet evropiane Erasmus të mobilitetit.</p> <p>3. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që studentët në përfundim të studimeve në Master i Shkencave në “Shkenca Politike” lehtësisht mund të aplikojnë në institucione rajonale edhe më gjerë për studime të mëtejshme ose të përafërta, apo diploma t’u njihet pasi përmbush standardet evropiane. Ka pasur raste studentësh të përfshirë në programin Erasmus+.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>1. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, në mënyrën e ndërtimit përmban dy komponentë: a) Aftësimin teoriko-aplikativ nëpërmjet leksioneve dhe seminareve në auditor, si dhe Praktikën; b) Kërkimin shkencor nëpërmjet punës së pavarur të finalizuar me përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>2. Vazhdimësia e programeve të studimit nga Bachelor në Master i Shkencave në “Shkenca Politike” reflekton strategjinë e UMSH për përgatitjen e specialistëve të administratës publike dhe studiuesëve të çështjeve politike e sociale në vend.</p> <p>3. Në realizimin në nivel bashkëkohor dhe me cilësi të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” i gjithë personeli akademik angazhohet në kërkime shkencore referuar faktit që ata kanë marrë gradën shkencore “Doktor” dhe punës shkencore të tyre të pasqyruar në dosjet e personelit.</p> <p>4. Angazhimi dhe përkushtimi i personelit akademik në punën kërkimore shkencore evidentohet në evidencën e UMSH për periudhën 2012-2018 ku Departamenti i Shkencave Politike kishte pjesëmarrje të konsiderueshme në shumicën e aktiviteteve shkencore të raportuara nga UMSH.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë</p>	Këto kritere nuk i përkasin programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.

<p>nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<ol style="list-style-type: none"> Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar, referuar njohurive që ofron përmes lëndëve “Njohuri të telluara mbi krahasimin e sistemeve politike”, “Globalizimi, lëvizjet sociale dhe politikat sociale”, “Analizë Politike” “Institucionet dhe Administrata e BE-së”, etj. Institucioni i orienton studentët në mundësitë e punësimit përmes kontakteve me të diplomuarit nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, bashkëpunimeve me institucione të administratës publike dhe institucioneve jo publike e private, agjenci punësimi, ku pas praktikave në to janë punësuar një numër i studentëve në mbarim të programit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” (RVB Tabela 18; RVJ, Tabela nr.11.1 në Aneks). Një studim tregu i mirëfilltë nuk është realizuar nga institucioni, por ato bashkëpunojnë me agjenci punësimi private dhe subjekte publike e private që orientojnë UMSH në kërkesat e tregut.
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<ol style="list-style-type: none"> Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare referuar përmbajtjes së lëndëve dhe formës së realizimit të programit. Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” ka synim parësor ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare të promovuara përmes bashkëpunimeve me bashkitë kryesore të vendit, pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare.
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<ol style="list-style-type: none"> Konstatohet se grupi i vetëvlerësimit nuk është shprehur për këtë kriter në RVB. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedat gjate vizitave në vend, GVJ konstaton se programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është në përputhje me kërkesën e 120 ECTS të realizuar në dy vite akademike sipas standardeve. Ndërsa për projektin kërkimor dhe Mikrotezën që duhet përgatitur në përfundim të këtij programi Msc. janë përcaktuar 20 ECTS, gati 70% e normës së kërkuar prej 30-40 ECTS.
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>2. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p>
---	---

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>1. UMSH dhe Departamenti i Shkencave Politike u ofron studentëve gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, syllabuset, praktikën mësimore si dhe rregulloren për frekuentimin e lëndës përmes: sekretarive, pedagogëve që i njohin studentët në fillim të lëndës me syllabusin, tutorëve dhe webit të UMSH.</p> <p>2. Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në formë elektronike, nga sistemi në rrjet ku janë vendosur studentë dhe pedagogë për shkëmbimin e leksioneve, detyrave, si dhe nëpërmjet broshurave të printuara.</p>
---	--

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>1. UMSH ka rregulla të përcaktuara për diplomimin, për formën dhe organizimin e përmbajtjes së tezave të provimeve që shpjegojnë mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve. Temat e diplomave që zgjedhëm në Bibliotekën e UMSH ishin të strukturuar sipas standardeve dhe shkrimit akademik. Kishte raste kur udhëheqësi shkencor ishte me Msc.</p> <p>2. Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është në përputhje me kërkesën e 120 ECTS të realizuar në dy vite akademike sipas standardeve. Ndërsa për projektin kërkimor dhe Mikrotezën që duhet përgatitur në përfundim të tij janë përcaktuar 20 ECTS, 70% e normës së kërkuar prej 30-40 ECTS.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është hartuar në përmbushje të misionit dhe objektivave strategjike të UMSH, duke u mbështetur në përvojat e univeriteteve europiane me të cilat universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi dhe universiteteve nga është diplomuar një pjesë e stafit akademik. Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është ndërtuar mbi bazën e sistemit të Bolonjës duke aplikuar sistemin ECTS në tërësinë e programit dhe të syllabuseve të lëndëve. Plani mësimor përmban të gjithë elementët e tij i organizuar në lëndë/module me kreditet përkatëse, madje edhe brenda një lënde kreditet ndahen mes leksioneve dhe seminareve me orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Sistemi ECTS i aplikuar ka mundësuar transferimin e studentëve nga universitet evropiane të Italisë e Greqisë në UMSH apo aplikimin e studentëve të UMSH në programet evropiane. Plani mësimor ndahet sipas disiplinave të formimit të përgjithshëm, formimit karakterizues dhe disiplinave të ngjashme duke realizuar një ndërthurje harmonike të tyre nëpër tre semestra. Mungojnë lëndët me zgjedhje të cilat krijojnë fleksibilitet dhe mundësi tërheqje për studentët që u konstatua gjatë bisedës me ta. Semestri i katërt i është rezervuar praktikës dhe mikrotezës. Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është në përputhje me stadardeve të cilësisë, sipas të cilave lëndët/modulet vlerësohen me kredite (ETCS). Nga përmbajtja duket i ngurtësuar pasi nuk ka bërë ndryshime në 6 vite, megjithë ndryshimet e stafit akademik efektiv që është rritur në sasi dhe kualitet. Stafit akademik është i përbërë nga profesorë dhe lektorë me gradën shkencore “Doktor”, të aftë për të drejtuar punën kërkimore shkencore dhe aftësimin e studentëve për përmbylljen e programit Msc. me një studim individual. Në përfundim të programit të studimit Master Shkencor në Shkenca Politike studentët janë pajisur me njohuritë, aftësitë dhe

kompetencat e kërkuara për këtë nivel studimi nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve. Ruajtja e interesit dhe vlerave kulturore kombëtare karakterizojnë programin e studimit duke i dhënë përputhshmëri të plotë me legjislacionin kombëtar dhe me direktivat e BE-së. Diplomimi i studentëve realizohet mbi një plan të caktuar kohor, i cili është i mjaftueshëm për përfundimin me sukses të ciklit të dytë të studimeve (2 vite akademike), ndonëse për tezën e diplomës ka nevojë t'u lihet më tepër kohë dhe numri i krediteve nga 20 të shkojë në 30-40. Mikrotezat në të gjitha rastet do të drejtohen nga personel akademik me gradën shkencore "Doktor".

Standardi I.1 përmbushet pasi institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara sipas ECTS.

Standardi I.2 përmbushet pasi programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Politike i pajis studentët të cilët zotërojnë diplomën Bachelor me njohuri të thelluara teorike dhe i ndihmon ata në kërkimin shkencor që finalizohet me Mikrotezën.

Standardi I.4 përmbushet pasi programi Master i Shkencave në "Shkenca Politike" synon jo vetëm të zgjerojë njohuritë teorike të studentëve, por t'i pajisi ata me aftësi përmes orëve të seminareve, punës së pavarur dhe lëndës së Praktikës, si dhe kompetenca përmes detyrave të lëndëve dhe mikrotezës së diplomës, duke iu përgjigjur nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Standardi I.5 përmbushet pasi programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është ndërtuar mbi bazën e modeleve të programeve Europiane dhe po zbatohet përmes një bashkëpunimi ndërkombëtar në mjaft aspekte.

Standardi I.6 përmbushet referuar përkushtimit të personelit akademik në punën shkencore për periudhën 2012-2018 të evidentuar përmes pjesëmarrjes në shumicën e aktiviteteve shkencore të raportuara nga UMSH.

Standardi I.8 përmbushet ndonëse një studim tregu i mirëfilltë nuk është realizuar nga institucioni, por ato bashkëpunojnë me agjenci punësimi private dhe subjekte publike e private që orientojnë UMSH në kërkesat e tregut.

Standardi I.9 përmbushet referuar përmbajtjes së lëndëve dhe formës së realizimit të programit ka synim parësor ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare të promovuara përmes bashkëpunimeve me bashkitë kryesore të vendit, pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare.

Standardi I.12 përmbushet pasi programi është realizuar në dy vite akademike me 120 ECTS, ndërsa për Mikrotezën janë përcaktuar vetëm 20 ECTS, gati 70% e normës së kërkuar prej 30-40 ECTS.

Standardi II.6 përmbushet pasi informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në formë elektronike i aksesueshëm nga studentë, pedagogë dhe gjithë personat e interesuar.

Standardi II.8 përmbushet pasi u konstatua që UMSH ka rregulla të përcaktuara për diplomimin, për formën dhe organizimin e përmbajtjes së tezave të provimeve që shpjegojnë mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve.

Për këto arsye **standardet plotësohen kryesisht.**

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Organizimi i mësimdhënies realizohet sipas standardeve në mjedise të pajisura me të gjithë logjistikën e nevojshme. Mësimdhënia e lëndëve të veçanta që përmban programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" organizohet në formën klasike leksione dhe seminare. Nga takimi me stafin akademik dhe studentë kuptuam që në pesë vitet e fundit ishin futur forma të reja të mësimdhënies si Kinemaja politike, që gjerësisht përdoret në universitetet amerikane. Pedagogu zgjedh një film që trajton tema politike dhe diskuton me studentët për konkretizimin e ideve politike, dhe ky projekt vazhdon për 10 javë. Salla në katin e parë ishte mëse e përshtatshme për një veprimtari të tillë. Në lëndët e programit të studimit është aplikuar zhvillimi interaktiv i leksioneve, duke ftuar personalitete të fushës, leksione të hapura madje edhe konferenca me tema të politikës së aktualitetit, përpjekje që e bën procesin mësimor të jetë sa më tërheqës dhe i kuptueshëm, konkret. Studentët diskutojnë mbi këto çështje kryesore duke shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin nën moderimin e pedagogut përgjegjës.

Ngarkesa mësimore është e ndarë sipas normave mbi ngarkesën mësimore që duhet të ketë çdo pedagog, ndonëse përcaktimi prej 270 orësh fizike në auditor sipas Zyrës së Burimeve Njerëzore duket i lartë në kuptimin që stafi akademik ngarkohej edhe me punë administrative. Shpërndarja e lëndëve në departament është bërë duke u bazuar në kualifikimin dhe fushën e studimit të pedagogëve me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Referuar Tabelës nr.7 në aneks evidentohet se një lëndë/modul ka 6,7 ose 8 ECTS, të cilat përmbushen përmes një numri orësh në auditor prej 60-90 orësh. Referuar Tabelës nr.8 në aneks shumica e lëndëve kanë një pedagog përgjegjës, i cili duhet të mbulojë 3-4 lëndë, jo domosdoshmërisht në këtë program studimi, që të realizojë një total prej 240-270 orësh mësimore në auditor. Nëse profesorët dhe lektorët do të kishin nga një asistent, kjo mund tua lehtësonte ngarkesën në auditor, duke iu krijuar hapësira edhe për punë kërkimore. Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies mund të marri në konsideratë edhe këtë element të ngarkesës. Vlerësimi realizohet në forma të larmishme duke marrë feedback nga titullarët si në ndjekjen e leksioneve nga përgjegjësi i departamentit; nga dekani dhe Zyra e Burimeve Njerëzore përmes formularëve të vlerësimit. Po ashtu, janë marrë mendime nga studentët përmes anketimit për lëndët e zhvilluara gjatë semestrit dhe përmes formularëve të vetëvlerësimit të personelit akademik. Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë është i dukshëm, jo vetëm në vlerësimin e procesit mësimor, por edhe në angazhimin në punë administrative, si sekretaria, labororet, në panairin e ideve që zhvillohet çdo vit, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Plotësuar Tabela e Planit nr. 7 në aneks):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Referuar RVB, Tabelës nr. 9 në aneks, dhe diskutimeve me personelin akademik dhe studentët, format kryesore të mësimdhënies janë pasqyruar sipas standardeve pa specifikuar format e tjera të larmishme të përdorura gjatë mësimdhënies të dhëna nëpër syllabuset e lëndëve. Tradicionalisht leksionet zene sasinë e orëve më të mëdha 555 orë në auditor, të ndjekur nga seminarët me 360 orë në auditor dhe po kaq orë ka Praktika, 360 orë në auditor. GVJ sugjeron që në një program Masteri Shkencor mund të kishte më pak orë në auditor (1335-gjithsej) dhe më tepër orë pune të pavarur (1665-gjithsej), bazuar në nevojën për të fituar shkathtësi dhe kompetenca të kërkimit shkencor dhe mundësive të bashkëpunimeve të shumta që UMSH ka me subjekte publike e jopublike, vendase dhe të huaja, për t'i aftësuar studentët në punë kërkimore dhe profesionale.

Format e kontrollit të njohurive

Në klasifikimin e formave të kontrollit të njohurive, të përcaktuara në syllabuset e lëndëve të përfshira në dokumentin nr. 12 në sistem, vihet re një klasifikim i diferencuar i tyre sipas lëndëve, që nuk është pasqyruar në larminë e vet në RVB sipas Tabelës nr. 10 në aneks, por duket tepër i thjeshtëzuar në tre elemente si më poshtë:

- 1) Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive që ze 10% të vlerësimit, ndërkohë që për nivelin Master leksionet dhe seminarët në auditor zenë një peshë specifike të madhe në format e mësimdhënies. Vendosja e standardit të pjesëmarrjes së studentëve në mbi 70% të orëve të mësimin ka rëndësi në nivelin e të nxënit, prandaj ky element mund të ishte më i lartë edhe në vlerësimin e dijeve, që në disa syllabuse është reflektuar, si në atë mbi Institucionet dhe Administrata e BE ku pjesëmarrja vlerësohet me 15% të notës, ka vendosur Brainstorm si forme kontrolli së bashku me testimet.

- 2) Punimi i esesë apo detyrës së kursit varion në syllabuset nga 10-25% e vlerësimit të lëndës;
- 3) GVJ sugjeron reduktimin e masës prej 60% të peshës specifike që mban provimi final, duke vendosur vlerësime periodike për projektet e studentëve në panairin e ideve, në debatet në kinemanë politike, që kanë hyrë tashmë si tradita të përvitshme në veprimtarinë e Departamentit të Shkencave Politike.

GVJ sugjeron që në të gjitha syllabuset ky element të evidentohet saktë, pasi në një pjesë të tyre nuk ka specifikime me përqindjen që zenë format e vlerësimit në notën finale.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit shkencor të departamentit në nivel Masteri mbase nuk është evidentuar i plotë te RVB, referuar në Tabelën 12 në aneks. Aty vetëm 46 studentë rezultojnë të jenë përfshirë në rang universiteti. Sikur puna për realizimin e temave të diplomës të 42 studentëve të diplomuar nga programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” në këto 5 vjet të ishte përfshirë, rezultati do të ishte ndryshe.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Plani mësimor i ndryshuar në fillim të vitit 2018, i miratuar nga Senati Akademik i UMSH dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Në RVB, kjo pjesë fillon me këtë frazë: “Pranimi i studentëve në programin Master i Shkencave në Shkenca Politike është bërë në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke iu përgjigjur Standardit IV.1, Kriteri 2. në mënyrë shabllone. Nga diskutimet me sekretarinë ku studentët regjistrohen dhe me titullarët e institucionit dhe studentët u konfirmua se pranimet në këtë program Master i Shkencave në “Shkenca Politike” janë bërë konform Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” që ka zëvendësuar Ligjin e vitit 2007. Ndryshimi kryesor është se studentët që në hyrje duhet të dëshmojnë njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE, kriter ky që u është kërkuar nga UMSH studentëve që në regjistrimin në këtë program studimi. Nga konsultimet e dosjeve të studentëve, veç një rasti që kishte kryer studime të ciklit të parë në Itali, në pjesën më të madhe mungonte dokumenti i dëshmisë së gjuhës së huaj. UMSH është proaktiv në promovimin e institucionit në gjithë vendin për tërheqjen e studentëve të rinj. Veçanërisht kjo bëhet edhe me e domosdoshme me konkurueshmërinë që ka në programet Master i Shkencave në “Shkenca Politike” nga universitetet publike dhe private në Shqipëri. Rreth 50% e studentëve të Bachelorit në Shkenca Politike në UMSH vazhdonin programin Master i Shkencave pasi ishin të familjarizuar me programin dhe procedurat e pranimit, mjedisin akademik dhe infrastrukturën. Në studentët aktualë kishte një pjesë të mirë që vinin nga universitete të tjera nga brenda dhe jashtë vendit. Nga viti 2012-2013 ka një dinamikë në rritje të numrit të studentëve nga 17 në 19 studentë në vitin akademik 2014-2015 dhe pastaj ka një tendencë rënie deri në vitin 2017-2018 ku janë regjistruar 12 studentë. Ka pothuajse të njëjtën trajektore sikurse numri i studentëve të Bachelorit. Në të gjitha vitet është përmbushur standardi i numrit minimal prej 10 studentësh për hapjen e programit Master i Shkencave. E rëndësishme është edhe cilësia në hyrje e studentëve, të cilët kanë ruajtur mesataren e hyrjes 7.3 në vitin akademik 2012-2013 dhe po aq edhe në 2017-2018, referuar Tabelës nr.11.2 në aneks. Sigurisht që numri i studentëve në hyrje është më i madh sesa i atyre të diplomuar në këto 6 vite, kurse mesatarja e daljes ka tendencë të jetë më e lartë. Kalueshmëria e studentëve lidhet në shumicën e rasteve, sipas statistikave, me mosfrekuentimin e tyre, përderisa një pjesë e mirë janë të punësuar në biznese private apo vijnë nga jashtë Tiranës. Shumica e të diplomuarve janë punësuar në profesione të përafërta nga vetë institucionet ku kanë zhvilluar praktikat. Komunikimi

me ish-studentët vazhdon rregullisht përmes rrjetit Alumni, madje në disa raste ata i janë bashkuar projekteve të UMSH edhe pas diplomimit, si në rastin me agjencinë e punësimit the Headhunter Shpk. Ajo çfarë konsiderohet si një objektivi për t'u arritur është ndërkombëtarizimi dhe rritja e reputacionit të UMSH për të tërhequr studentë dhe profesorë nga shtetet e tjera të Mesdheut për zhvillimin e një qasjeje rajonale.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve në programin Master i Shkencave në "Shkenca Politike" janë të unifikuara me ato publike, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH" dhe UMSH i ka respektuar këto rregulla. Pranimi është i hapur për të gjithë studentët me diplomë Bachelori, pavarësisht degës ku janë diplomuar. Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në bëhet mbështetur në dokumentacionin e paraqitur sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve të Institucionit nga një komision i caktuar nga Dekani dhe miratohen nga Senati Akademik.

Studentët e rinj aplikantë informohen nëpërmjet webit të UMSH dhe sekretarisë. Në javën e parë të studimeve organizohet "Java e Informimit" si javë orientuese për studentët e rinj. Në procedurën e pranimit të studentëve u jepet informacion për programin, për ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që e zhvillojnë atë, për format e mësimdhënies dhe kontrollit të saj, për librat që përdoren në procesin e mësimdhënies, për literaturën që përdoret edhe on-line dhe se si do të gjejnë atë dhe syllabuset për çdo lëndë. Studentëve u vihet në dispozicion një email personal ku u dërgohet përsëri udhëzimi nga tutori që është përgjegjës për ta, duke specifikuar të drejtat dhe detyrimet e tyre. Rol të rëndësishëm luan dhe ZKSK që i mbështet studentët, jo vetëm gjatë pranimit, por gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre si dhe orienton ata në mundësitë për kryerjen e studimeve të mëtejshme të doktoraturës. Nga biseda me një pjese të student të pranuar, ata konfirmuan se informacionin për të zgjedhur këtë program studimi e kishin marrë nga studentët e diplomuar në UMSH (ALUMNI). Manuali i Studentit është një udhëzues i mirë për çdo student të UMSH. Studenti regjistrohet në sekretarinë mësimore duke dorëzuar diplomën e Bachelorit me gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe duke paguar tarifën e regjistrimit, e pastaj nënshkruan kontratën e studimit, sipas Rregullorjes organizative të UMSH, neni 51. Sekretaria mësimore mban të dhënat e regjistrimit të studentëve nëpër regjistra dhe programe kompjuterike ku dokumenton të gjitha informacionet e nevojshme mbi to. Personeli ishte i ndërgjegjshëm për të zbatuar edhe kriterin ligjor të pranimit si njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian, konkretisht anglishtes.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Referuar Tabelës 11.2 në aneks)

Referuar të dhënave statistikore të Sekretarisë mësimore, pasqyruara në Tabelën 11.2 në aneks, cilësia në hyrje përgjatë periudhës 2012-2017 duket e mirë, përderisa nota mesatare e hyrjes së studentëve të regjistruar në vitin e parë është mbi 7, me përjashtim të vitit 2014-2015 ku prurjet nga universitetet private të mbyllura e kanë rritur numrin nga 11 studentë një vit më parë në 19 studentë, duke ulur notën mesatare në 6.5, e cila në vitin e fundit akademik 2017-2018 është rritur në 7.4. Ndërsa në dalje, nota mesatare e studentëve përgjithësisht rritet, si pasojë e punës individuale që bëhet me ta nga stafi akademik, sikurse u vërtetua edhe nga biseda me studentët gjatë takimit në UMSH. Numri i të diplomuarve është mesatarisht 50% e të regjistruarve, pra jo të gjithë që hyjnë e mbyllin ciklin e dytë të studimeve me sukses.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Referohu te Tabela nr.11 në aneks):

Studentët e regjistruar në vitin e parë për herë të parë kanë pasur oshilacione ngritje dhe zbritje nga 2012 në 2017, duke arritur numrin më të lartë në vitin akademik 2015-2016 me 19 studentë. Ky hop është i lidhur me prurjet nga universitetet e tjera private të mbyllura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilët kanë ulur cilësinë, referuar notës mesatare në hyrje që zbrit në 6.5, duke vazhduar të rritet mbi 7 në vitet në vijim, sikurse edhe numri i studentëve të regjistruar ulet në 12 studentë. Në çdo vit është respektuar standardi i minimumit 10 studentë për hapjen e një programi Masteri dhe i kriterit hyrës me notën mesatare mbi 6.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare (Referohu te Tabela nr.11.2 në aneks)

Referuar të dhënave të marra nga takimi me sekretarinë mësimore në UMSH, rezulton se gjatë periudhës 2012-2017, numri i studentëve të diplomuar nga programi Master Shkencor në Shkenca Politike është më i vogël sesa të regjistruarit, me një kalueshmëri rreth 50%, ndërsa nota mesatare e tyre është më e lartë sesa në hyrje, me përjashtim të vitit të fundit akademik 2016-2017 (Referohu te Tabela nr. 11.2 në aneks).

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend (Referohu te Tabela nr. 11 në aneks).

Të dhënat e transferimeve në Tabelën nr.11 në aneks provojnë se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë njih kreditet e përfituara dhe transferon studimet, midis programeve të të njejtit cikël studimi, brënda të njejtit institucion dhe në institucione të tjera. Transferimet lejohen brënda të njejtit cikël studimesh në fusha studimi të njejtja ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve bëhen sipas akteve ligjore të përcaktuara nga Ligji "Për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH" Nr. 80/2015 dhe në Statutit të UMSH, neni 76. Njohja e plotë ose e pjesshme e krediteve të fituara nga studentët me qëllim vazhdimin e studimeve në UMSH kryhet nga një komision *ad hoc*.

- Të dhëna për punësimin e studentëve (Referohu te Tabela nr.11.1 në aneks)

Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mban kontakte të rregullta me të diplomuarit. Nga të dhënat për punësimin e të diplomuarve në këtë program Masteri për periudhën 2013-2017 ka një rekord tepër pozitiv, ku 80 përqind janë të punësuar. Një pjesë e studentëve të këtij programi studimi janë të punësuar që në hyrje dhe përgjatë studimeve. Ndërkohë UMSH iu krijon mundësinë e praktikave në institucione të ndryshme publike e private, apo organizata të shoqërisë civile, Në semestrin e fundit, ku pas përfundimit të studimeve u ofrohen edhe mundësi punësimi. Nga takimet në UMSH morëm informacionin se një nga studentët e tyre të diplomuar vite më parë kishte krijuar një agjenci punësimi, The Headhunter Shpk., dhe orientonte studentët në tregun e punës. Bazuar në përvojën e punës me të ai zhvillonte lenden e Praktikës me studentët.

- Numri total i të diplomuarve (Referohu te Tabela nr.11.1 në aneks)

Numri total i të diplomuarve që ka referuar RVB dhe të nxjerra nga sekretaria mësimore është 42, nga 85 të regjistruar për periudhën 2012-2017. Kjo është një shkallë e kënaqshme kalueshmërie prej 50%.

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) (Referohu te Tabela nr.11.1 në aneks)

Për periudhën 2013-2017, referuar RVB, ka një rekord pozitiv për punësimin e të diplomuarve në

këtë program Masteri, ku gjysma e tyre 50% janë punësuar në përputhje me titullin e diplomës.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) (Referohu te Tabela nr.11.1 në aneks)

Për periudhën 2013-2017, referuar RVB, ka një rekord pozitiv për punësimin e të diplomuarve në këtë program Masteri, ku 30 përqind e tyre janë punësuar jo në përputhje me titullin e diplomës.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Të dhëna nga sekretaria mësimore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master, si dhe të diplomuarit me notën mesatare në hyrje dhe në dalje për periudhën 2012-2018 (Shih Tabelën nr. 11.1 në aneks).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p>	<p>1. Studentët që ndjekin programin Master i Shkencave në “Shkenca Politike” zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 ECTS, i verifikuar me sekretarinë mësimore. Përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” bëhet nga një komision i ngritur nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.</p> <p>2. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p> <p>3. UMSH për pranimin e studentëve në programin Master i Shkencave respekton kriteret ligjore në fuqi. UMSH nuk ka kriteret shtesë pranimi, ndonëse pranimet bëhen në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të institucionit, bazuar në Rregulloren e Programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, neni 12.</p> <p>4. Një nga kriteret ligjore për pranimin në programin e studimit të ciklit të dytë është njohja nga fituesit e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE të cilën UMSH e ka aplikuar me pranimet e studentëve të Masterit Shkencor të këtij viti akademik. Dokumenti i dëshmisë së gjuhës së huaj duhet të jetë në dosjen e studentit.</p>

<p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>5. Fakti që rreth 50% e studentëve të diplomuar në Bachelor në Shkenca Politike në UMSH vazhdojnë Master i Shkencave në “Shkenca Politike” tregon se institucioni ka harmonizuar programet e studimit në të dy ciklet. Institucioni nuk ka vendosur barriera apo kritere kufizuese në lidhje me degët e studimit të Bachelorit për këtë program studimi Master i Shkencave në “Shkenca Politike”.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>1. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ndihmon në ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve, të mund të orientohen në tregun e punës. Krahas saj, përmes lëndës së praktikës dhe bashkëpunimeve me institucionet e tjera publike dhe jopublike, për studentët sigurohen informacione në lidhje me mundësitë për punësim.</p> <p>2. Studentët informohen që para se të nisnin studimet në UMSH mbi statusin e programeve dhe pastaj në mënyrë të detajuar është planifikuar java e parë e fillimit të studimeve për informim për gjithshka ka iu intereson atyre mbi organizimin e programit të studimit, statusin e akreditimit, apo njohjen brenda e jashtë vendit e cila mundësohet lehtësisht nga zbatimi i sistemit të moduleve dhe ECTS.</p> <p>3. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës është një strukturë që funksionon pranë UMSH, e cila drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit universitar, si dhe orienton dhe këshillon ata mbi kërkesat e tregut të punës duke mbajtur kontakte me të diplomuarit, agjencitë e punësimit dhe subjektet e tjera bashkëpunëtoresh të UMSH.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>1. Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar në këtë periudhë 5 vjeçare, si në regjistra edhe në format elektronik në sekretarinë mësimore dhe në Departamentin e Shkencave Politike.</p> <p>2. Institucioni, nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Departamentit mban një bazë të dhënash në lidhje me statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, që kryesisht ndodh për shkak të mosfrekuentimit. Në regjistrin mësimor që përdor pedagogu verifikuar pasqyrimin e mungesave të studentëve që nuk</p>

<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>frekuentonin lëndët përkatëse, ndonëse ka disa lëndë me regjistrin e paplotësuar përfundimisht, ndonëse është fundi i vitit akademik.</p> <p>3. Departamenti dhe sekretaria mësimore mbajnë të dhëna të përditësuara nëpër rregjistra dhe në formate elektronike për studentët që nga pranimi dhe deri në diplomim. Formatet e rregjistrave ishin sipas modelit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>1. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mban në vazhdimësi statistika për karrierën e të diplomuarve të UMSH, nëpërmjet kontakteve me ta përmes rrjetit Alumni. Punësimi është një nga objektivat kryesore të studimeve në UMSH i arritur përdërisa 80% nga të diplomuarit në këtë program janë punësuar dhe 50% e të diplomuarve janë punësuar në institucione publike apo joqeveritare në profilin e tyre dhe 30% jashtë profilit. UMSH zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me agjenci punësimi që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve. UMSH njëkohësisht ka ndjekur politika favorizuese të punësimit të studentëve më të mirë edhe brenda institucionit.</p> <p>2. Përafërsisht 50% e të diplomuarve nga Bachelori ndjekin programet Master, pas përfundimit të të cilave studentët punësohen. Me statusin e Universitetit hapen mundësitë e vazhdimit të studimeve në programe të Doktoraturës në UMSH.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>1. Studentët që në javën e parë të fillimit të studimeve informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, organizimin e tij në 4 semestra, afatin e përfundimit jo më vonë se dyfishi i kohës normale, pra në 4 vjet dhe me procesin e akreditimit të programit. Kjo javë realizohet në mënyrë të programuar me angazhimin, jo vetëm të personelit akademik e administrative, por edhe të studentëve nga Këshilli Studentor. Nga biseda me studentët se nga e kishin marrë informacionin e parë për UMSH doli që ishin të diplomuarit nga ky universitet.</p> <p>2. Studentët informohen mbi format e kontrollit dhe vlerësimit të lëndës nga titullarët e lëndëve, sikurse konfirmuan gjatë bisedës vetë studentët. Titullari i lëndës u bën me dije rezultatet e vlerësimit shoqëruar me pikët që kanë marrë për</p>

	<p>frekuentimin, esetë, detyrat apo testet e zhvilluara.</p> <p>3. Nga bisedat me studentët u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira të studentëve me stafin akademik, ku studentëve iu jepej mundësia të diskutonin hapur me përgjegjësit e moduleve mbi mënyrën dhe rezultatet e vlerësimeve, të cilat sikurse rezultojnë nga nota mesatare janë më të larta sesa nota mesatare hyrëse në këtë program studimi.</p>
--	--

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

1. Gjithë personeli akademik dhe ndihmës e administrativ dhe në mënyrë të veçantë Tutori angazhohen vazhdimisht dhe ndihmojnë studentët në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor.

2. Për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, ZKSK në bashkëpunim me pedagogun e caktuar për lëndën e Praktikës dhe me agjencinë e punësimit The Headhunter ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucioneve ku ata mund të kryejnë praktikën e cila zgjat 6 javë në semestrin e fundit. Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me institucione të ndryshme në të cilat studentët zhvillojnë praktikën dhe ka përgatitur një format për vlerësimin me notë të saj si nga pedagogu dhe nga personi përgjegjës për praktikën në institucionet ku mund të zhvillohet praktika. (Referohu te Tabela nr. 17 mbi marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikën). Studentit i njihet e drejta e zgjedhjes së institucionit të praktikës, që mund të jetë edhe organizata ku ata janë të punësuar, nëse ka lidhje me profilin e tyre.

Konkluzionet e vlerësimit:

UMSH ndjek politika të mirëorganizuara për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve me parimin “Studenti në qendër”. Kjo u verifikua nga vizita në UMSH, në takimet me studentët dhe personelin, ku reflektoheshin marrëdhënie shumë të mira dhe të hapura bashkëpunimi. Institucioni organizon javën e parë për mirëpritjen dhe dhënien e informacioneve studentëve të rinj që realizohej në mënyrë të programuar me angazhimin, jo vetëm të personelit akademik, por edhe të studentëve dhe personelit administrativ. Përveç studentëve të rinj, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë përfshirjes së të gjithë studentëve në jetën institucionale, nëpërmjet mundësisë së angazhimit në Këshillin Studentor, në Zyren e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe në punë në formën e internshipit. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në bashkëpunim me agjenci të specializuara për politikën e punësimit orienton studentët për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillojnë praktikën, duke i ndihmuar në ofrimin e mundësive për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. GVJ sugjeron që dokumenti i mbrojtjes së gjuhës së huaj të jetë pjesë e dosjes së studentëve.

Standardi IV.1 përmbushet sepse përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” bëhet për të gjithë ata që kanë një diplomë Bachelori, pa

specifikime për degën e studimit.

Standardi IV.2 përmbushet pasi Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ndihmon në dhënien e çdo informacioni mbi statusin e institucionit, programit dhe ofrimin e mundësive që të orientohen në tregun e punës.

Standardi IV.3 përmbushet sepse institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar në këtë periudhë 5 vjeçare.

Standardi IV.4 përmbushet pasi Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mban në vazhdimësi statistika për karrierën e të diplomuarve të UMSH, nëpërmjet kontakteve me ta përmes rrjetit Alumni.

Standardi IV.5 përmbushet pasi studentët që në javën e parë të fillimit të studimeve informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve.

Standardi IV.6 përmbushet pasi personeli akademik dhe ndihmës e administrativ dhe në mënyrë të veçantë Tutori angazhohen vazhdimisht dhe ndihmojnë studentët.

Institucioni i plotëson plotësisht standardet.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Me kalimin nga Shkollë e Lartë në Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, kërkimi shkencor merr një rëndësi të veçantë si pjesë përbërëse e veprimtarisë së personelit akademik dhe institucionit, sikurse rezultoi edhe nga diskutimet me drejtuesit dhe stafin akademik. Gjatë vizitës në UMSH biseduam me drejtuesin e Qendres së Kërkimit Shkencor, një njësi që përbëhet nga dy zyra, atë të Marrëdhënive me Jashtë dhe atë të Projekteve. Kërkimi shkencor realizohej përmes një rrjeti bashkëpunëtorësh me institucione akademike, të administratës publike dhe organizatave jo publike e private që Qendra Mesdheu kishte siguruar që nga krijimi i saj (Tabela nr.17 në aneks). Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, kërkimi shkencor kryhet në fushat sipas të cilave janë të organizuara edhe grupet e pedagogëve: Çështje aktuale në fushën e studimeve politike; Zhvillimin e platformave të komunikimit politik; dhe Çështje që lidhen me integrimin europian. Një aspekt i veprimtarisë shkencore është pjesëmarrja e pedagogëve në zbatimin e granteve kërkimore-shkencore të financuara nga universitete dhe institucione të tjera, që zenë 5% të burimeve të financimit të UMSH. Puna shkencore për finalizimin e studimeve të doktoraturës apo postdoktorale është pjesë përbërëse e stafit akademik. UMSH mbështet financiarisht pjesëmarrjen e pedagogëve në udhëtime studimore në universitete dhe institucione të huaja. Botimet e punimeve shkencore të pedagogëve ofrohen nga UMSH Press që deri tani ka botuar 10 numra të Revistës shkencore periodike EUROMEDITERRANEAN (ku mund të publikohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj), kopjet e së cilës i konsultuam në Bibliotekën e UMSH. Stafit pedagogjik si dhe tezat më të mira të studentëve u jepet mundësia për t'i publikuar edhe në International Journal of Euro-Mediterranean Studies.

Departamenti i Shkencave Politike në Bashkëpunim me Departamentin e Marrëdhënive Ndërkombëtare realizon aktivitetin e përvitshëm “Kinemja Politike në 10 javë”. Ky aktivitet konsiston në ndjekjen e dhjetë filmave të përzgjedhur nga pedagogët, iniciativë e kthyer në traditë. Studentët dhe pedagogët analizojnë ndikimin e politikës në kinematografi dhe anasjelltas, si dhe efektivitetin e përdorimit të kinemasë si mjet për të arritur qëllime politike. Krahas pedagogëve, studentët bëhen pjesë në debatin që realizohet pas përfundimit të filmit përkatës.

Në aktivitetet shkencore të organizuara nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” kanë marrë pjesë të gjithë pedagogët e lëndëve që përfshihen në programin e studimit Master në Shkenca Politike, dëshmi ishte konferenca shkencore e zhvilluar me datë 1 Qershor, 2018 në Tirana Internacional me pjesëmarrjen dhe referimin e profesorëve të huaj dhe Kryeministrit e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të qeverisë shqiptare mbi zhvillimin e qendrueshëm dhe politikën e punësimit. Rritja e

kërkimit shkencor të pedagogëve ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e mësimdhënies si dhe në larminë e literaturës së përdorur. Në takimet e zhvilluara në departament puna kërkimore u evidentua nga secili pedagog dhe ishte e pasqyruar në dosjen e tij personale që na u vu në dispozicion nga zyra e burimeve njerëzore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Referohu te Tabela nr.13 në aneks)

Nga takimet në UMSH dhe evidenca mbi aktivitetin shkencor të institucionit për periudhën 2012-2018, del qartë se Departamenti i Shkencave Politike ka një angazhim serioz në veprimtaritë kërkimore shkencore si brenda dhe jashtë vendit. Më konkretisht, disa tregues të matshëm për periudhën 2012-2018 janë pasqyruar në Tabelat nr.13, 14 në aneks, ku Departamenti i Shkencave Politike ka tregues në lidhje me pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda (10) e jashtë vendit (34), në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj (12), botime të artikujve shkencorë brenda (26) e jashtë vendit (3), monografi (6) dhe pjesëmarrje në programe lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare (3). Mungojnë të dhënat mbi numrin e studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor, ndërkohë që për studentët e Masterit Shkencor mund të konsiderohet si e tillë puna që ata bëjnë për Mikrotezën nën udhëheqjen e pedagogëve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga biseda me Rektorin e UMSH morëm evidencën mbi aktivitetin shkencor të njërive bazë të UMSH për periudhën 2012-2018, nga e cila evidentohen të dhënat respektive mbi Departamentin e Shkencave Politike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>1. Personeli akademik që mbulon programin mësimor Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është i angazhuar në publikime të artikujve dhe materialeve shkencore. Këto publikime janë evidentuar nga statistikat të cilat mbahen periodikisht dhe raportimet individuale të secilit pedagog të pasqyruar në dosjet që disponon Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>2. Aktiviteti kërkimor shkencor i stafit akademik ka kontribuar në zhvillimin e fushave konkrete studimore, duke ofruar mendime dhe ide inovatore në Shkencat Politike referuar kumtesave mbi analizat e problematikave më të rëndësishme politike të aktualitetit në lidhje me zhvillimin e qendrueshëm dhe punësimin të diskutuara në konferencën shkencore me 1 Qershor, 2018.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>2. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>1. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" informon periodikisht stafin pedagogjik mbi programe të kualifikimit brenda dhe jashtë vendit. Edhe aktivitetet që organizon si konferencat shkencore, projektet e bashkëpunimit, revista shkencore, abonimet, etj., i shërbejnë këtij qëllimi. Në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë" janë ftuar shpesh herë personalitete të fushës së Shkencave Politike për të referuar dhe për të ndarë me kolegët eksperiencat personale.</p> <p>2. Nga biseda me stafin akademik konfirmohet se UMSH mbështet kualifikimet e stafit akademik. Disa nga Lektorët e Departamentit të Shkencave Politike vazhdojnë aktualisht studimet doktorale pranë universiteteve evropiane. Personeli akademik mbështetet financiarisht për pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>1. Institucioni disponon një bazë të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në "Shkenca Politike", të cilat na u vunë në dispozicion gjatë vizitës në UMSH (Tabela nr.13 në aneks).</p> <p>2. Të dhënat e botimeve mbahen të detajuara mbi artikuj brenda e jashtë vendit, në shqip apo gjuhë të huaj, monografi, pjesëmarrje në konferenca e projekte brenda e jashtë vendit. Një kopje e botimeve të publikimeve shkencore gjendet në Bibliotekën e UMSH.</p> <p>3. Nga Tabela nr.17 në aneks del qartë aktiviteti me projekte bashkëpunimi kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Niveli i kualifikimit të stafit akademik dhe politikat e UMSH në mbështetjen e rritjes së kapaciteteve të tij për kualifikim të vazhdueshëm, duke u ofruar mbështetje financiare si dhe</p>	

infrastrukturore, janë një nga pikat e forta të këtij institucioni. Në funksion të saj UMSH ka krijuar struktura të posaçme për mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të rritjes së aktivitetit shkencor në forma të larmishme, si Qendra e Kërkimit Shkencor dhe një rrjet të gjerë bashkëpunimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Institucioni disponon një bazë të dhënash me tregues konkret të punës kërkimore që nga konferencat shkencore, botimet në revistat me faktor impakti, duke qenë anëtar i EMUNI, botimet shkencore të stafit akademik, apo dhe të studentëve kanë mundësi të publikohen në *International Journal of Euro-Mediterranean Studies*. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me institucionet publike i kanë shërbyer lidhjes së teorive politike me zhvillimet aktuale duke i ofruar studentëve prekje të aktualitetit, jo vetëm lexim të librave. UMSH ofron infrastrukturën e nevojshme për kërkimin shkencor, si për stafin akademik edhe për studentët.

Standardi III.3 përmbushet pasi aktiviteti kërkimor shkencor i stafit akademik të programit është i larmishëm sipas tre fushave studimore.

Standardi III.10 përmbushet pasi aktivitetet që organizon si konferencat shkencore, projektet e bashkëpunimit, revista shkencore, abonimet, etj., në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë" i shërbejnë kualifikimit profesional të personelit.

Standardi III.11 përmbushet pasi institucioni disponon një bazë të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në "Shkenca Politike", të cilat referohen në Tabelën nr.13 në aneks.

Institucioni i plotëson standardet plotësisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Marrëdhëniet institucionale të bashkëpunimit në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar të UMSH dëshmojnë për një traditë të konsoliduar marrëdhëniesh dhe hapjeje të institucionit si me universitete homologe, ashtu dhe me institucione publike dhe jopublike. Për bashkëpunimin në nivel lokal mund të përmenden Memorandumi i Bashkëpunimit të UMSH me Njësinë bashkiake Nr.1 në Tiranë, me Bashkinë Durrës dhe me Bashkinë Sarandë; në nivel kombëtar bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Tiranës, Avokatin e Popullit etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe si me Akademinë Diplomatike të Londrës, me Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë; LUM Jean Monnet University, Casamassima (BA), Itali; Universitetin e Qipros; Universitetin e Strugës; Kolegjin Universitar "Biznesi" me seli në Prishtinë etj., sikurse pasqyrohen në Tabelën nr.15 në aneks.

Këto bashkëpunime kanë mundësuar mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel rajonal e ndërkombëtar me pjesëmarrjen në aktivitete e projekte të ndryshme. Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi edhe me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmenden bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës; Aleancën e Biznesit të Kosovës; Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë; Shoqatën e Bankave të Shqipërisë; Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësisimit të Shqipërisë etj. Duke pasur prioritet kryesor aftësimin e studentëve në fushën e shkencave politike, janë krijuar mundësi për kryerjen e praktikës mësimore për studentët e programit të studimit Master në Shkenca Politike në institucione të tilla që kanë realizuar edhe punësimin e tyre pas diplomimit. Po ashtu, marrëdhëniet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar i kanë shërbyer rritjes së aktivitetit shkencor si në konferencën shkencore të organizuar në Tirana Internacional me datë 01.06 2018.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (plotësuar Tabela nr.17 në aneks)

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" ka përfituar nga marrëdhëniet e bashkëpunimit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve të stafit akademik, të punës mësimore e kërkimore dhe të praktikave të studentëve. Në këtë kuadër, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka nënshkruar më shumë se 50 marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe jo arsimore në nivel lokal, kombëtar si dhe ndërkombëtar. Në strategjinë e institucionit është zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimeve, veçanërisht me vendet e Mesdheut në realizimin e qëllimeve të Qendrës Mesdheu që ka iniciuar hapjen e UMSH. UMSH në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit ka mundësuar edhe punësimin e studentëve. Referuar Tabelës nr.17 në aneks evidentohen bashkëpunimet me çdo institucion që Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë ka kontratë bashkëpunimi dhe specifikohet plani i veprimtarive konkrete të bashkëpunimit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotësuar te dhenat ne aneks)

UMSH ka krijuar rrjetin e partnerëve në rajon duke bashkëpunuar në fusha me interes të përbashkët për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Kështu, UMSH është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Si anëtar i këtyre rrjeteve, UMSH është në marrëdhënie dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. UMSH ndjek një politikë nxitëse për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar duke mundësuar dhe financiar pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme akademike brenda dhe jashtë vendit ku kanë marrë pjesë disa anëtarë të personelit të tij akademik.

Për fenomenet e reja në fushën e politikave ekonomike dhe sociale shqiptare, si ato të përcaktuara nga strategjitë kombëtare apo të ndikuara nga zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, stafi akademik dhe studentët e programit Msc. në Shkenca Politike kanë pasur rastin të debatojnë me qeveritarë dhe specialistë të fushës në leksione të hapura, konferenca shkencore dhe studime të përbashkëta.

Të shumta dhe të efektshme janë lidhjet që UMSH ka krijuar dhe realizuar me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës ku vend të veçantë ze bashkëpunimi me Headhunter shpk. në qendër të së cilës është realizimi i praktikave mësimore të studentëve si dhe punësimi i tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	1. Ky kriter nuk i përket programit të studimit subjekt i këtij vlerësimi.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	2. Në realizimin me sukses të programit të studimit Master Shkencor në Shkenca Politike institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qeveritare, në nivel qendror dhe lokal, dhe organizata profesionale të cilat bëjnë të mundur zhvillimin e praktikave. Këto marrëveshje bashkëpunimi dhe praktika kanë mundësuar edhe punësimin në mjaft raste të studentëve.

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>1. UMSH ka institucionalizuar bashkëpunimin e brendshëm midis stafit pedagogjik, atij administrativ, shkëmbimin e informacioneve ndërmjet njësive, por edhe ndërmjet personelit, në funksion të rritjes së cilësisë së këtij programi studimi, sikurse u evidentua nga vizita në UMSH, krahas shqyrtimit të rregulloreve të funksionimit të brendshëm.</p> <p>2. UMSH ka krijuar të gjitha mekanizmat e nevojshëm, lehtësues në shërbim të realizimit të ndarjes së qartë të funksioneve dhe kompetencave ndërmejt personelit. Personeli akademik angazhohet edhe me detyra administrative si në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Tutoriatin për studentët, etj. Aplikimi i ndarjeve të sakta të detyrave ka bërë që puna të jetë më e organizuar dhe që ecili të përgjigjet për detyrat e tij dhe në rritjen e një fryme bashkëpunimi në institucion.</p>
--	---

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>1. UMSH për realizimin e një procesi mësimor modern mundëson bashkëpunime me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja, publike dhe private, sikurse pasqyrohet në Tabelën nr.15 në aneks.</p> <p>2. Këto marrëdhënie mundësojnë që gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë të studimeve në programin Master i Shkencave në "Shkenca Politike", studentët të kryejnë praktikat për të realizuar objektivat e programit të studimit. Në momentin që studentët pranohen në kryerjen e praktikës, ata mbikqyren në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu përgjegjës për praktikën i Departamentit i cili mban kontakte me ofruesin e praktikës dhe plotësojnë së bashku formatin për vlerësimin.</p> <p>3. UMSH në bashkërendim me bashkitë me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi organizon trajnime profesionale të stafit në fushën e shkencave politike.</p> <p>4. Në përfundim të praktikave mësimore Departamenti në bashkëpunim me partnerët bëjnë një raport analitik të rezultatit të këtyre praktikave, dhe se si ato kanë ndikuar në formimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Për këtë qëllim UMSH ka institucionalizuar një format raportimi.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ndjek politika të qarta të rritjes së kapaciteteve institucionale, qoftë përmes bashkëpunimeve me aktorë vendas dhe të huaj, qoftë përmes rritjes së nivelit të bashkëpunimit brenda institucionit mes njësive të ndryshme të tij. UMSH i ka kushtuar struktura të posaçme bashkëpunimit si Qendra për Kërkim Shkencor me zyrën e projekteve. Institucioni për organizimin dhe zbatimin e programit të studimit nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit, i provuar nga fakti që programi i studimit Master në Shkenca Politike mbulohej nga staf akademik i brendshëm i dy Fakulteteve të UMSH. Po ashtu, ka bashkëpunime institucionale

që mundësojnë praktikën dhe punësimet e studentëve.

Standardi V.3 përmbushet pasi në realizimin me sukses të programit të studimit Master Shkencor në Shkenca Politike institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qeveritare, në nivel qendror dhe lokal, dhe organizata profesionale të cilat bëjnë të mundur zhvillimin e praktikave.

Standardi VII.1 përmbushet pasi UMSH ka institucionalizuar bashkëpunimin e brendshëm midis stafit pedagogjik, atij administrativ, shkëmbimi i informacioneve ndërmjet njësive, por edhe ndërmjet personelit, në funksion të rritjes së cilësisë së këtij programi studim

Standardi VII.2 përmbushet sepse UMSH për realizimin e një procesi mësimor modern mundëson bashkëpunime me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja, publike dhe private, sikurse pasqyrohet në Tabelën nr.15 në aneks.

Institucioni i plotëson standardet e kësaj fushe plotësisht.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është një program i akredituar për herë të parë në 2012 dhe tani kërkon të riakreditohet duke patur një histori 6 vjeçare suksesi. Sikurse paraqitet edhe në fillim të këtij Raporti të Vlerësimit të Jashtëm duke iu referuar Vendimit të Këshillit të Akreditimit nr.303, datë 13.01.2012 për programin e studimit Master Shkencor në Shkenca Politike mbi plotësimin e rekomandimeve nga akreditimi i parë, institucioni duket se ka punuar në përmbushjen e tyre në disa drejtime.

Sa i takon rekomandimit të parë:

a) Përmirësimi i planit mësimor të lëndëve të programit të studimit është kryer në drejtim të përfshirjes së literaturave bashkëkohore, metodave interaktive të mësimdhënies, ndërsa lëndët kanë mbetur të pandryshuara. Në planin mësimor mungojnë lëndët me zgjedhje, të cilat jo vetëm që janë të kërkuara në standardet e cilësisë, por janë të kërkuara edhe nga studentët e Masterit.

b) Programi ka aplikuar sistemin ETCS në të gjitha ndarjet e moduleve/ lëndëve, ndonëse mbetet i ulët numri i krediteve të mikrotezës, aktualisht 20, sipas standardeve shtetërore të cilësisë për programet e studimit Master Shkencor duhen 30-40 ECTS.

Për periudhën 2012-2018 të këtij akreditimi programi nuk ka pësuar ndryshime në planin mësimor dhe në aplikimin e sistemit të krediteve në kategorizimin e moduleve, praktikës dhe diplomës.

Rekomandimi **përmbushet kryesisht.**

Sa i takon rekomandimit të dytë:

a) Institucioni në rrugën drejt rritjes së statusit të tij në universitet, ka krijuar struktura të reja si Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike me Departamentin e Shkencave Politike.

b) Ky Fakultet dhe Departamenti i Shkencave Politike kanë rritur numrin e pedagogëve me kohë të plotë të cilët mbulojnë kryesisht lëndët e këtij program studimi. Ka vetëm një personel akademik me kontratë në cilësinë e asistentit të titullarit të lëndës mbi institucionet e BE që justifikohet.

c) Edhe cilësia e stafit akademik ka ardhur duke u rritur nëpërmjet marrjes së gradës "Doktor" nga pedagogët e mëparshëm, por edhe disa rekrutimeve të reja, kryesisht me staf akademik me PhD të fituar në universitete evropiane. Kriteri i stafit akademik efektiv me gradën shkencore Doktor që mbulon këtë program Master i Shkencave në "Shkenca Politike" është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi **përmbushet plotësisht.**

Sa i takon rekomandimit të tretë:

a) Për të tërhequr studentë të rinj dhe me rezultate të larta, institucioni ka parashikuar dhënie e bursave për studentët me rezultate të larta, duke siguruar rritjen e cilësisë së studentëve.

b) Studentëve të këtij programi studimi u është kërkuar të japin në fillim, jo në përfundim të studimeve provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat ligjore.

Rekomandimi **përmbushet plotësisht.**

Si konkluzion i këtyre fakteve, mund të thuhet se institucioni i ka përmbushur rekomandimet plotësisht.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” është bashkëkohor dhe përmbush misionin e UMSH dhe objektivat e programit për dhënien e njohurive, aftësive dhe kompetencave studentëve të shkencave politike që të bëhen politologë, administratorë dhe funksionarë publikë, të aftë për të kontribuar në zhvillimin politik të qëndrueshëm të vendit.
- Stafi akademik i programit të studimit është një nga pikat e forta që garanton cilësinë e realizimit të programit. Të gjithë janë personel akademik efektiv, përzgjedhur me kujdes dhe përmbushin kriteret e kompetencave sipas lëndëve me gradën shkencore “Doktor”, i dominuar nga grupmosha e mesme, me aspirata për rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe të veprimtarisë kërkimore.
- Ka një kombinim të menduar të stafit si në përbërje gjinore, në aspektin e arsimimit brenda vendit dhe në universitete të njohura jashtë vendit, me jo vetëm akademike, por edhe në drejtimin e administratës publike.
- Ka raporte të mira gati 50:50, të stafit mësimor dhe atij administrativ mbështetës të angazhuar për realizimin e programit të studimit.
- Ka infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e programit të studimit dhe për çdo element studimor dhe kërkimor-shkencor. Interneti është i pranishëm në çdo mjedis të godinës, e cila zotërohet përmes një kontrate deri në vitin 2021.
- Biblioteka e pasur dhe abonimet në biblioteka on-line si Questia, sigurojnë plotësimin e të gjitha kërkesave, si për detyrimet mësimore të studentëve, ashtu dhe për punën shkencore të pedagogëve.
- Bashkëpunimet me partnerët janë një nga pikat e forta të institucionit që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e vazhdueshme të nivelit të mësimdhënies, të punës shkencore, që u mundësojnë studentëve të vitit të dytë të kryejnë këtë praktikë në institucione që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e tyre të studimit, duke iu krijuar mundësi punësimi.
- Politika e bursave që ndjek institucioni kanë mundësuar ndjekjen e programeve të studimit nga studentë me rezultate të mira dhe nga studentë të aftë të cilët nuk kanë mundësitë financiare.

b. Pika të dobëta:

- Referuar analizës për përmbushjen e rekomandimeve, do të konsiderohet si pikë e dobët përmirësimi i programit për të qenë korrekt me standardet e plotësimit të 30-40 ECTS për mikrotezën dhe për të qenë më fleksibël duke vendosur lëndë me zgjedhje.
- Pikë e dobët mund të konsiderohet financimi i UMSH që kryesisht realizohet nga tarifat e studentëve. Burime alternative të lidhura me konsulentat dhe kërkimin shkencor janë të mundshme, bazuar në stafin akademik dhe në bashkëpunimet brenda e jashtë vendit.

c. Mundësitë:

- Rritja e numrit dhe cilësisë së studentëve, politikat e mbështetjes me bursa të tyre, infrastruktura që UMSH ka në dispozicion të realizimit të programit të studimit, potencialet njerëzore të stafit akademik dhe atij administrativ, bashkëpunimet e shumta e të gjithanshme me aktorë vendas dhe të huaj, kanë rritur reputacionin e UMSH dhe e kanë vendosur në një stad ku mundësitë duken në rritje, si për rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimor, ashtu dhe për lidhjet me tregun e punës.
- Ndërkombëtarizimi dhe rritja e reputacionit të UMSH për të tërhequr studentë dhe profesorë nga shtetet e tjera të Mesdheut.

d. Pengesat:

- Programet Bachelor dhe Master në Shkenca Politike janë një nga më të ofruarit nga shumica e universiteteve private, duke e vendosur UMSH në një konkurrencë të lartë përzgjedhjen e këtij programi.
- Centralizimi i sistemit të pranimeve në nivelin Bachelor dhe vendosja e kriterit të notës mbi 6 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mund të ndikojë në reduktimin e numrit të

studentëve në Bachelor, dhe për rrjedhojë edhe në programin Master, pasi nga të dhënat rezulton që mbi 50 përqind e studentëve të këtij Masteri vijnë nga të diplomuarit e Bachelorit të UMSH.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asoc. Dr. Merita Vaso Xhumari



SUMMARY OF THE ANALYSIS FOR EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

I. SUMMARY OF THE ANALYSIS FOR FULFILLMENT OF FIRST ACCREDITATION RECOMMENDATIONS

The study program Master of Sciences in "Political Sciences" is an accredited program carried out for the first time in 2012 and actually is in the process of its reaccreditation based on a 6 years successful story. As it is presented at the beginning of this External Evaluation Report referring to the Accreditation Council Decision no. 303, dated on January 13, 2012 in regard to the study program Master of Sciences in "Political Sciences" for the fulfillment of recommendations of the first accreditation, the institution seems to have worked out in its completion in several directions.

In regard to the first recommendation:

a) The teaching plan improvement of the program study subjects is carried out in terms of contemporary literature inclusion, interactive methods of teaching, while the subjects have remained the same ones. In the teaching plan are missing the subject by choice, which are the ones not only required in reference to the quality standards, but are also required from the students of Master level.

b) The program has applied the ETCS system in all parts of modules/ subjects, but the number of credits for the micro-thesis remains low, actually 20, while according to the state quality standards for study programs Master of Sciences, the number of credits should have been 30-40 ECTS.

During the accreditation period of 2012-2018, the program has not been changed as far as the teaching plan and its application of the credits system in relation to the categorization of modules, practice and diploma.

The recommendation **is partially completed.**

In regard to the second recommendation:

a) The institution in its way of improving its status from higher school to university, has created several new structures, as the Faculty of Psychological, Social and Political Sciences with its Department of Political Sciences.

b) Such a new Faculty and the Department of Political Sciences have increased the full time of academic staff number that are covering almost all the subjects of this study program. There is one contracted academic staff in the quality of assistant professor of the subject of EU institutions that it is justified.

c) The quality of academic staff has also been improved through getting the PhD grade of the previous lecturers, and with the new recruitment, mainly academic staff with PhD earned through the studies in the European universities. The criteria of having the effective academic staff with PhD grade in the study program of Master of Sciences in "Political Sciences" has been fully completed.

The recommendation is **fully completed.**


In regard to the third recommendation:

a) In terms of the purpose for getting new students and also with high academic results, the institution has planned granting scholarships to students with high academic results, guaranteeing in this way the increased number of quality students.

b) This study program does require to its students to have earned the completion of English language at the admission stage and not after getting it, through international recognized tests, in accordance to the legal requirements.

The recommendation is **fully completed.**

These facts lead us to the conclusion that the institution has fully completed the recommendations.



II. SWOT ANALYSIS (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

e. Points of strengths:

- The study program Master of Sciences in “Political Sciences” is a contemporary one and does meet the mission of UMSH and its program objectives to knowledge delivery, skills and the competencies to the students of political sciences to become politologist, administrator and public officials, capable to contribute in sustainable political development of the country.
- Academical staff of the study program is one of the points of strengths in guaranteeing the quality of program implementation. All the staff is an efective academic personel, carefully selected that is able to meet the criterias of competencies to respective subjects with scientific grade of PhD, dominated by the middle group age, motivated to increase the quality of teaching and of scientific research activities.
- It has a thoughtfully combined staff in regard to gender, education studies in country and in well known foreign universities, not only with an academic carreer, but also with an experience in public administration positions.
- It has a good combination of 50:50, between the academical staff and the administrativ support one fully engaged for the study program implementation.
- It has a suitable infustructure for study program implementation and for each of its study program elements and scientific-research activities. Internet is present in all the facilities of the university. For this building, the university has a contract up to 2021.
- The library is supplied with on-line libraries like Questia, and it satisfies the demands of all, of the students for completing their academic duties and of the lecturers for their scientific activities.
- The collaboration with partners is one of the institutional points of strength which reflects in one side, the continious increase at the teaching level and the scientific work, and on the other side, it makes possible that all second year students may carry out their practice in institutions, fully suitable to their study areas, creating in this way empoyment opportunity.
- The scholarship policy of the university has made possible for students of high academic results to follow the study programs, as well as for good students with little financial capacity.

f. Points of weaknesses:

- Referring to the analisis for recommandation implementation, it will be considered as point of weakness the program improvement in order to be correct in meeting the standards of having 30-40 ECTS for the microthesis and being more flexibel by having subject by choice.
- Point of weakness could be considered the finances of USHM mainly through the students tariffs. Alternative financing resources are possible through the consultancy on scientific research, undertaken by the academic staff in collaboration within country and out of it.

g. Opportunities:

- The number and students' quality increase, the support policies for students scholarships, UMSH infrastructure available to study program, human potential of academic and administrative staff, the number and the diversity of collaborations with in country and foreign actors, have increased the UMSH reputation and have put it in the stage where the opportunities are going to be increased, in regard to the improvement of quality teaching and research process, as well as for the relations with job market.
- The international recognition and the increased reputation of UMSH to get students and professors from other Mediteranean countries.

h. Obstacles:



- The Bachelor and Master programs in Political Sciences are the most offered ones in most private universities, placing UMSH in high competition for being chosen for such program.
- The centralised system of students admission in Bachelor level and the criteria of having the grade six and higher from the Ministry Education, Sport and Youth, may influence to the decrease number of students in Bachelor, and as the consequence also in the Master program, based on the datas that over 50 percent of students in Master level are those coming from graduates of UMSH's Bachelor level.

External Evaluation Team

Prof. Asoc. Dr. Merita Vaso Xhumari



ANEKSE

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

(Marrë nga RVB dhe Anekset)

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike (Viti akademik 2017-2018)	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total		Numri PA
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	
Departamenti i Shkencave Politike	8	5	3	1	11	6	
Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	9	6	7	5	16	11	
Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë	7	3	0	0	7	3	
Në Total	24	14	10	6	34	20	12

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike (Viti akademik 2016-2017)	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total		Numri PA
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	
Departamenti i Shkencave Politike	11	6	7	3	18	9	
Departamenti i Marredhenieve Nderkombetare	9	4	6	3	15	7	
Departamenti i Shkencave Juridike	16	10	9	8	24	18	
Në Total	36	20	22	14	57	34	12

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike (Viti akademik 2015-2016)	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total		Numri PA
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	
Departamenti i Shkencave Politike	8	3	2	1	9	4	
Departamenti i Marredhenieve Nderkombetare	8	3	5	2	10	5	

Departamenti i Shkencave Juridike	10	6	9	7	19	13	
Në Total	26	12	16	10	38	22	12

Tabela 2. Staf i akademik për programin e studimit Master i Shkencave ne Shkenca Politike
Sipas Gjinitise, Viti akademik 2017 - 2018

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Gjinia F / M	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Gjinia F / M	Titulli /Grada
1	Inis Shkreli	F	PhD	1	Klajda Gjoshja	F	Msc
2	Nexhmi Dumani	M	Prof.As.Dr				
3	Zhaneta Saliu	F	Dr.				
4	Kriton Kuci	M	PhD (c)				
5	Zhanklina Xheraj	F	PhD				
6	Edon Qesari	M	PhD				
7	Skender Demaliaj	M	Dr.				
8	Perparim Kabo	M	Prof.As.Dr				
9	Ilir Aliaj	M	Dr.				
10	Alketa Elezi	F	Prof.As.Dr				
11	Gertjan Veshaj	M	Msc				
12	Emilio Cika	M	Dr proces				

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentet perkatese

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike Departamenti i Shkencave Politike, Viti akademik 2017-2018							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Nexhmi Dumani	Pedagog	Prof.As	1	Artan Lila	DR	Universiteti i Elbasanit
2	Skender Demaliaj	Shef Departamenti	DR	2	Enian Lamce	Drp	Ministria e Jashtme
3	Ilir Aliaj	Kërkimi Shkencor	DR	3	Ilir Hebovija	Msc	Administrartor UMSH
4	Zhaneta Saliu	Lektor	PhD				
5	Zhanklina Xheraj	NJSBCZK	PhD				
6	Emilo Cika	Lektor	Drp				
7	Gertjan Veshaj	Lektor/Tutoriati	Msc				

8	Ledina Memishaj	Lektor	Msc			
---	-----------------	--------	-----	--	--	--

Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike Departamenti i Administrimit Publik dhe Formimit Bazë, Viti akademik 2017-2018						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Denada Dervishi	As.Lektor	Msc			
2	Drita Avdyli	Lektor	Dr			
3	Enxhia Sala	As.Lektor	Msc			
4	Eros Angjeli	As.Lektor	Msc			
5	Nevila Xhindi	Pergjegjes Dep/Lektor	Prof.As			
6	Roland Sahatcia	Lektor	Dr			
7	Zirina Llambro	As.Lektor	Msc			

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike Departamenti i Shkencave Politike, Viti akademik 2016-2017							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Ela Tollkuci	Lektor	Msc	1	Emilio Çika	Drp	AMC
2	Gertjan Veshaj	Lektor	Msc	2	Ilir Hebovija	Msc	Administrator UMSH
3	Iliriana Kuçana	Lektor	Msc	3	Ani Bajrami	Dr	Universiteti Shtetëror i Tiranës
4	Kriton Kuçi	Lektor	PhD c	4	Blerina Hamzallari	Msc	Universiteti Shtetëror i Tiranës
5	Mihal Zoto	Lektor	PhD c	5	Brikena Balli	Dr	Universiteti Shtetëror i Tiranës
6	Mimoza Ahmeti	Lektor	Dr	6	Mirela Çekani Lika	Prof	Universiteti Shtetëror i Tiranës
7	Nexhmi Dumani	Rektor/ Lektor	Prof.As	7	Nazmi Shtino	Msc	Qendra Spitalore Universitare
8	Perparim Kabo	Dekan/ Lektor	Prof.As				
9	Skender Demaliaj	Pergjegjes Dep/ Lektor	Dr				
10	Zhanklina Xheraj	Lektor	PhD				
11	Zhaneta Saliu	Lektor	PhD				

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike Departamenti i Shkencave Politike, Viti akademik 2015-2016					
Personeli Akademik	Detyra në	Titulli	Personeli	Titulli	Institucioni

Efektiv (Emër Mbiemër)	Dep.	/Grada	Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	/Grada	ku punon full time		
1	Gertjan Veshaj	Lektor	Msc	1	Emilio Çika	Drp	AMC
2	Ilir Hebovija	Lektor	Msc	2	Artan Lila	Dr	Universiteti i Elbasanit
3	Ilir Aliaj	Lektor	Drp				
4	Iliriana Kuçana	Lektor	Msc				
5	Kriton Kuçi	Lektor	PhD c				
6	Skender Demaliaj	Pergjegjes Dep/ Lektor	Dr				
